



Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës

RAPORTI I PARË



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

**Dhomat e Specializuara
dhe Zyra e Prokurorit
të Specializuar të Kosovës**

RAPORTI I PARË



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Përmbajtja

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS	5
Parathënie	6
Historiku	8
Momente kyçe të DHSK-së	10
Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në	12
Dhomat	14
1 Struktura dhe përbërja e Dhomave të Specializuara	15
2 Emërimi i gjykatësve	16
3 Instrumentet ligjore themelore	20
4 Krijimi i kornizës procedurale	25
5 Marrëdhëniet e jashtme	26
Komunikimi dhe ndërgjegjësimi	27
Zyra Administrative	33
1 Kabineti i Administratores (KA)	35
2 Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJIKP)	37
3 Zyra e Auditimit	39
4 Zyra e Avokatit të Popullit	39
5 Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore	40
5.1 Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ)	40
5.2 Njësia e Shërbimeve Gjuhësore (NJSHGJ)	40
5.3 Zyra e Mbrojtjes (ZM)	41
5.4 Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV)	42
5.5 Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD)	43
5.6 Njësia e Paraburgimit (NJP)	43
6 Seksioni i Administratës	44
6.1 Njësia e Burimeve Njerëzore (NJBNI)	44
6.2 Njësia e Teknologjisë së Informacionit (NJTI)	46
6.3 Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP)	46
6.4 Njësia për Siguri (NJS)	47
6.5 Njësia e Financave dhe Buxhetit (NJFB)	47
6.6 Njësia e Prokurimit (NJP)	48

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR	49
Parathënie	50
Zhvillimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar	52

**DHOMAT E
SPECIALIZUARA
TË KOSOVËS**

Parathënie

Është privilegj të paraqesim raportin e parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës – një institucion i ri me mandatin ligjor për kryerjen e procedurave penale, të pavarura, të paanshme, efikase dhe të drejta, në një mjedis të sigurt.

Shpesh harrohet ose lihet pa u dokumentuar se sa shumë mund dhe bashkëpunim duhet për ngritjen dhe vënien në funksionim të një gjykate penale me kapacitetet për t'u marrë me çështje të ndërlikuara të shkeljeve së të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut. Me anë të këtij raporti, dëshirojmë të rrëfejme dhe theksojmë disa prej arritjeve kyçe gjatë procesit dinamik prej prillit 2016 deri në korrik 2017 që kanë çuar në funksionalizimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në aspektin gjyqësor. Raporti gjithashtu përvijon edhe zhvillimet prej korrikut 2017 deri në shkurt 2018.

Duke pasur parasysh përkushtimin tonë për garantimin e një administrimi efektiv të gjykimeve të ardhshme, gjatë themelimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe përpilimit të Rregullores së Procedurës dhe Provave janë jetësuar shumë mësimet të vlefshme të nxjerra nga gjykata të tjera që janë marrë me krime ndërkombëtare. Shpresojmë që përvoja dhe mësimet e nxjerra gjatë krijimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës ku përfshihen elementë që nuk janë hasur ndonjëherë më parë në gjykata ndërkombëtare ose të ndërkombëtarizuara, do të kontribuojnë në mekanizmat e ardhshëm të llogaridhënies dhe drejtësisë.

Ne jemi të përkushtuar të sigurojmë që puna e Dhomave të Specializuara të Kosovës të raportohet në mënyrë transparente për një publik sa më të gjerë. Shpresojmë që këtë qëllim ta arrijmë pjesërisht

me anë të këtij raporti të parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, pas të cilit në të ardhmen do të vijojnë raporte të tjera të përvitshme.

Ngritja e Dhomave të Specializuara të Kosovës nga themelet ka paraqitur sfida të jashtëzakonshme. Falë punës së devotshme të punonjësve si dhe përkushtimit dhe ekspertizës së gjykatësve të Dhomave të Specializuara të Kosovës, këto sfida janë tejkaluar. Hyrja në fuqi e Rregullores së Procedurës dhe të Provave në korrik të vitit 2017, brenda pesë muajsh pas emërimit të gjykatësve, dëshmon për profesionalizmin, njohuritë dhe përkushtimin e tyre për krijimin e mjeteve ligjore për procedura efikase, të sigurta dhe të drejta para Dhomave të Specializuara të Kosovës. Për këtë u shprehim mirënjohjen tonë të thellë gjykatësve dhe tërë personelit.

Falënderojmë sinqerisht shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për mbështetjen e tyre financiare për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës. Po kështu, vlerësojmë shumë edhe ndihmesën bujare të Mbretërisë së Norvegjisë për rinovimin e mjedisit ku do të vendosen institucionet në të ardhmen, si dhe ndihmesën e Konfederatës së Zvicrës në mbështetjen të veprimtarive tona për komunikim dhe ndërgjegjësim. U shprehim mirënjohje gjithashtu edhe shteteve që na kanë mbështetur me personel të emëruar prej tyre.

Mirënjohja më e thellë i shkon Mbretërisë së Holandës si shteti pritës i procedurave të zhvendosura gjyqësore, si dhe ministrive të ndryshme të qeverisë holandeze për ndihmën e tyre në ngritjen dhe administrimin e sistemit të sigurisë dhe të masave praktike për funksionimin e institucioneve të zhvendosura në Holandë.

Falënderojmë më tej shtetet dhe anëtarët e komunitetit diplomatik për angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës.

U shprehim mirënjohjen tonë Përfaqësueses së Posaçme të Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalia Apostolova (Natalya Apostolova), Shefes së Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), Aleksandra Papadopulu (Alexandra Papadopoulou), dhe personelit të tyre për mbështetjen e tyre të vazhdueshme. Gjithashtu falënderojmë kolegët e Shërbimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian, Shërbimit të Komisionit Evropian për Instrumentin e Politikës së Jashtme dhe të Zyrës së Kapaciteteve për Planifikim dhe Drejtim Civil, për bashkëpunimin e tyre në çështjet administrative që lidhen me funksionimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

I vlerësojmë shumë marrëdhëniet e bashkëpunimit me gjykatat ndërkombëtare dhe të ndërkombëtarizuara në Hagë dhe gatishmërinë e tyre për të ndarë me ne përvojën e tyre për çështje organizative dhe administrative.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Hagë, mars 2018

Dhomat e Specializuara të Kosovës ende kanë shumë sfida përpara. Përgjegjësinë tonë ndaj popullatës së Kosovës e kemi në qendër të vëmendjes dhe vlerësojmë interesimin e tyre të madh për punën tonë. Kemi besim se me mbështetjen e institucioneve përkatëse në Kosovë dhe të autoriteteve të cekura më lart, do t'i kryejmë detyrat dhe do ta përmbushim mandatin tonë me sukses.

Gjithashtu, ne jemi të përkushtuar për një program të mirëkalibruar dhe të gjithanshëm komunikimi dhe ndërgjegjësimi i cili synon ngritjen e nivelit të njohurive dhe të vetëdijes për punën e Dhomave të Specializuara të Kosovës, nxitjen e dialogut me personat dhe komunitetet e prekura në Kosovë dhe në rajon, dhe pozicionimin e këtij institucioni si burim i besueshëm informacioni për procedurat e veta. Synimi ynë është që përmes konsultimeve të shpeshta me organizata, seance informative me gazetarë, programeve për studentë, takimeve të hapura me publikun, tryezave të rrumbullakëta dhe buletineve të përditësuara rregullisht, të japim informacione në kohë dhe të nxisim dialogun për punën dhe veprimtarinë e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Së fundi, ne jemi të vendosur të sigurojmë që Dhomat e Specializuara të Kosovës të shihen si pishtar i pavarësisë, paanshmërisë dhe drejtësisë, të panjollojura nga asnjë ndikim, ndërhyrje ose agjendë politike, dhe si mbrojtëse të fuqishme jo vetëm të të drejtave themelore të akuzuarve, por edhe të sigurisë së viktimave dhe dëshmitarëve.

Dr. Fidelma Donlon
Administratore e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Historiku

Në **qershor 2008**, Komisioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut emëroi një raportues të posaçëm për hetimin e pretendimeve për krime të rënda të kryera nga disa pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë dhe pas konfliktit të viteve 1998-1999.

Në **janar 2011**, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi me Rezolutën 1782 (2011) raportin e përgatitur nga raportuesi i posaçëm (Raporti i Këshillit të Evropës), në të cilin pretendohet se ishin kryer krime të shumta kundër serbëve, shqiptarëve të Kosovës të dyshuar për bashkëpunëtorë (të regjimit serb), dhe individëve të tjerë.

Në vijim të Raportit të Këshillit të Evropës, në **maj 2011**, shtetet anëtare të BE-së e shqyrtuan çështjen brenda kornizave të Komisionit Politik dhe të Sigurisë – organi që merret me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së. Pas kësaj u themelua Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), që u ngarkua me detyrën e kryerjes së hetimeve të pavarura të pretendimeve për ndalim të paligjshëm, dëbim, veprime çnjerëzore, tortura dhe vrasje, si dhe për çdo vepër tjetër penale lidhur me Raportin e Këshillit të Evropës. TFHS-ja u vendos në Bruksel dhe e filloi veprimtarinë e vet në **shtator 2011**.

Ndërkohë që vazhdonin hetimet, përmes një Shkëmbimi Letrash midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë, në **prill 2014**, u arrit një marrëveshje ndërkombëtare për themelimin dhe funksionalizimin e dhomave të

posaçme gjyqësore për ndjekjen penale të krimeve që do të rezultonin nga hetimet e TFHS-së.

Sipas **Shkëmbimit të Letrave**, këto dhoma gjyqësore do të krijoheshin brenda sistemit të gjykatave të Kosovës, por do të kishin statutin dhe rregulloren e tyre të procedurës dhe të provave dhe do të përbëheshin vetëm nga punonjës dhe drejtues ndërkombëtarë. Në Shkëmbimin e Letrave thuhet gjithashtu se dhomat e posaçme gjyqësore do të vendoseshin në një shtet të tretë dhe se procedurat e ndjeshme përfshirë dëgjimin e dëshmitarëve, do të kryheshin jashtë Kosovës. Shkëmbimi i Letrave u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me dy të tretat e votave në prill 2014 dhe u bë pjesë e legjislacionit vendor.

Në **korrik 2014**, Kryeprokurori i TFHS-së bëri një deklaratë sipas së cilës TFHS-ja “do të ishte në gjendje të ngrinte aktakuzë kundër disa zyrtarëve të lartë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

Në **nëntor 2014**, në vijim të Vendimit (CFSP) 2014/685 të Këshillit të BE-së të shtatorit 2014, u krijua i ashtuquajtura Ekip për Planifikimin e Gjykatës. Ekipi u vendos në Bruksel dhe u ngarkua me detyrën e shqyrtimit të mundësive për krijimin e këtij institucioni gjyqësor.

Në **mars 2015**, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës një amendament kushtetues të propozuar nga qeveria e Kosovës për vënien në zbatim të Shkëmbimit të Letrave. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhej të vlerësonte nëse amendamenti i propozuar cenonte ndonjë prej të drejtave dhe lirive të

garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Në **prill 2015**, Gjykata Kushtetuese e Kosovës u shpreh se amendamenti i propozuar ishte në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe se “struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i Dhomave të Specializuara do të rregullohet me ligje të mëtejme në pajtim me Kushtetutën”.

Ky amendament hyri në fuqi me nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës në **gusht 2015**. Në të njëjtën kohë u miratua edhe **Ligji** për krijimin e të dy institucioneve – instrumenti ligjor themelues i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Në **janar 2016**, Kosova dhe Holanda nënshkruan një Marrëveshje të përkohshme për Shtetin Pritës, çka i hapi rrugën fillimit të punës përgatitore për krijimin dhe funksionimin e DHSK-së në territorin e Holandës.

Në **prill 2016**, dr. Fidelma Donlon u emërua Administratore e Dhomave të Specializuara, çka shënoi fillimin e punës së Zyrës Administrative të DHSK-së në Hagë. Po në këtë kohë u bë zhvendosja e Ekipit për Planifikimin e Gjykatës nga Brukseli në Hagë. Një ekip prej 17 punonjësish me përvojë të madhe në fushën e tyre dhe në fushën e administrimit gjyqësor nisi punën për ngritjen dhe rritjen e shpejtë të Zyrës Administrative, për t'i mundësuar zbatimin e mandatit të vet administrativ dhe të mbështetjes gjyqësore.

Në **qershor 2016**, Këshilli i BE-së miratoi Vendimin (CFSP) 2016/947, ku ritheksohej mbështetja e vazhdueshme e BE-së për procedurat e zhvendosura. Këshilli i BE-së i kërkonte Komisionit Evropian “të nënshkruante një marrëveshje subvencionimi me një administrator që vepron në emër të zyrës administrative të ngarkuar me administrimin e procedurave të zhvendosura gjyqësore”. Ky vendim bëri të mundur administrimin e drejtpërdrejtë të institucioneve të

zhvendosura gjyqësore nga ana e Administratores, duke i hapur kështu rrugën administrimit të pavarur të DHSK-së.

Në **shtator 2016**, David Shvendiman (Schwendiman) u emërua Prokuror i Specializuar. Gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare e Dhomave të Specializuara në **dhjetor 2016** dhe filloi punë në atë post në janar 2017.

Më **1 janar 2017** hyri në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës sipas së cilës DHSK-ja mund të kryente procedura penale në territorin e Holandës. Pas kësaj, në **shkurt 2017**, u emëruan nëntëmbëdhjetë gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara. Në **mars 2017**, në Plenaren e tyre të parë, gjykatësit e Dhomave të Specializuara miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së Procedurës dhe Provave në **korrik 2017**, pas një shqyrtimi të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Dhomat e Specializuara u bënë plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor.

Në **nëntor 2017**, Administratorja miratoi Direktivën për Mbrojtësit e cila rregullon, ndër të tjera, kriteret për përzgjedhjen e mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave në Dhomat e Specializuara të Kosovës. Në të njëjtën kohë u hap edhe procedura e aplikimit për pranimit në Listën e Mbrojtësve.

MOMENTE KYÇE



JANAR 2011

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (KiE) miraton një Raport me titull "Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë".

PRILL 2014

Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri shkëmbejnë letra në lidhje me "dhoma të posaçme gjyqësore".

NËNTOR 2014

Formohet Ekipi për Planifikimin e Gjykatës.

2011

2012

2013

2014

2015

SHTATOR 2011

Fillon punën Task Forca Hetimore Speciale (TFHS) e krijuar nga Bashkimi Evropian për kryerjen e hetimeve penale në lidhje me pretendimet e Raportit të KiE-së.



GUSHT 2015

Kuvendi i Kosovës miraton nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

TË DHSK-së

JANAR 2016

Kosova dhe Holanda nënshkruajnë Marrëveshjen për Shtetin Pritës, në përgatitje të vendosjes së institucionit gjyqësor në Holandë në të ardhmen.

QERSHOR 2016

Këshilli i BE-së miraton një vendim për buxhetin vjetor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, që mundëson administrimin e drejtpërdrejtë të tij nga Administratorja.



DHJETOR 2016

Gjykatësja Ekaterina Trendafilova emërohet Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës.



SHKURT 2017

Emërohen 19 gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

2016

PRILL 2016

Dr. Fidelma Donlon emërohet Administratore e DHSK-së çka shënon fillimin e punës së institucionit gjyqësor në Hagë.



JANAR 2017

Hyn në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës e cila siguron bazën ligjore që i lejon DHSK-së kryerjen e procedurave gjyqësore në Holandë.

MARS 2017

Gjykatësit miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave e cila duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit nga ana e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

2017

KORRIK 2017

Hyn në fuqi Rregullorja e Procedurës dhe e Provave, pas shqyrtimit të kushtetutshmërisë së saj nga ana e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës bëhen funksionale në aspektin gjyqësor.

NJË VËSHTRIM

- Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë dy institucione të **pavarura**, të themeluara me anë të një **amendamenti kushtetues** dhe **Ligjit** për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës (Ligji), miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015.



- **Mandati** i Dhomave të Specializuara të Kosovës është
 - "të garantojnë procedura penale të sigurt, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime

të rënda ndërkuftare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pastij, të cilat ndërlihen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [...] dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale nga ana e Task Forcës Hetimore Speciale" (neni 1 i Ligjit).

- DHSK-ja është institucion gjyqësor i **përkohshëm** që do të ekzistojë vetëm për aq kohë sa do të jetë e nevojshme për gjykimin e akuzave të paraqitura nga Prokurori i Specializuar dhe deri sa Këshilli i BE-së ta njoftojë Kosovën për përfundimin e hetimeve dhe të procedurave.
- Dhomat e Specializuara të Kosovës janë pjesë e **sistemit të drejtësisë së Kosovës**. Ato:
 - përbëhen nga **të njëjtat nivele gjyqësore** si sistemi gjyqësor i Kosovës (themelor, apel, suprem, kushtetues);
 - kanë një **seli jashtë Kosovës**;
 - përbëhen nga gjykatës dhe punonjës që janë shtetas të **shteteve anëtare të BE-së, ose shteteve të treta kontribuuese**;

I SHPEJTË MBI DHSK-në

- zbatojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale, siç parashihet në Ligj; dhe
- zbatojnë rregulloren e tyre të procedurës dhe të provave.

- Dhomat e Specializuara të Kosovës merren vetëm me përgjegjësi penale individuale – ato nuk do të gjykojnë grupe apo organizata.

- **Juridiksioni** i DHSK-së përfshin:

- krime kundër njerëzimit, krime të luftës dhe krime të tjera sipas të drejtës penale të zbatueshme në kohën kur janë kryer krimet;
 - që kanë ndodhur në mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000;
 - që kanë filluar të kryhen ose janë kryer në Kosovë, ose që janë kryer nga persona me shtetësi kosovare/të RFJ-së, ose kundër tyre;
- krime kundër administrimit të drejtësisë, kur ato kanë lidhje me procedurat dhe/ose zyrtarët e Dhomave të Specializuara.

- DHSK-ja lejon **pjesëmarrjen e viktimave** në procedura.

- DHSK-ja dhe ZPS-ja **financohen** nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtete të treta kontribuuese dhe janë të pavarura në përmbushjen e mandatit dhe në kryerjen e punës së tyre.

“Dhomat e Specializuara nuk do të ndjekin penalisht asnjë grup etnik. Ato nuk do të ndjekin penalisht asnjë organizatë. Dhomat e Specializuara do të ndjekin penalisht dhe do të nxjerrin para përgjegjësisë vetëm individë.”

Kryetare Trendafilova (BIRN, 2017)


Dhomat

1 Struktura dhe përbërja e Dhomave të Specializuara

Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë dy organe: Dhomat dhe Zyrën Administrative. Dhomat përbëhen nga Kryetarja, nënkryetari dhe gjykatësit e tjerë nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë.

Dhomat janë themeluar brenda sistemit gjyqësor të Kosovës dhe pasqyrojnë strukturën e tij. Sipas

nenit 24 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), Dhomat përfshijnë një Dhomë të Gjykatës Themelore, një Dhomë të Gjykatës së Apelit, një Dhomë të Gjykatës Supreme dhe një Dhomë të Gjykatës Kushtetuese.



Struktura e Dhomave

Brenda kësaj strukture përfshihen, sipas nevojës, edhe gjykatës individualë që kryejnë funksionet e gjykatësit të procedurës paraprake, trupa gjykues (të përbërë nga tre gjykatës dhe një gjykatës rezervë), të Gjykatës Themelore, panele të Gjykatës së Apelit, panele të Gjykatës Supreme dhe panele të Gjykatës Kushtetuese, (që të gjithë të përbërë nga tre gjykatës), si dhe gjykatës të veçantë që kryejnë funksione tjera të parapara në Ligj.

Kryetarja është përgjegjëse për administrimin gjyqësor të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe është e vetmja gjykatëse e punësuar me orar të plotë. Administrimi gjyqësor përfshin: bashkërendimin e funksionimit të Dhomave; miratimin e udhëzuesve të praktikës gjyqësore dhe rregulloreve të tjera të brendshme; konsultimin dhe bashkërendimin me Administratoren dhe Prokurorin e Specializuar, sipas nevojës, për administrimin e

aktiviteteve gjyqësore; caktimin e periudhave të pushimeve të gjykatës; si dhe detyra të tjera të parapara në Ligj ose në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave. Kryetarja gjithashtu cakton gjykatësit e procedurave paraprake ose anëtarët e trupave gjykues, të paneleve të Gjykatës së Apelit, të Gjykatës Supreme apo Gjykatës Kushtetuese. Ajo përfaqëson Dhomat si organ dhe së bashku me Administratoren, përfaqëson Dhomat e Specializuara të Kosovës si institucion.

Sipas nenit 26 të Ligjit, gjykatësit janë të pranishëm në selinë e Dhomave të Specializuara vetëm sipas nevojës, me kërkesë të Kryetares, për të ushtruar funksionet që kërkojnë praninë e tyre. Kryetarja dhe gjykatësit ndihmohen nga juristë dhe nga personeli administrativ i Njësisë për Mbështetjen Juridike të Dhomave.

2 Emërimi i gjykatësve

Në korrik 2016, Shërbimi i Jashtëm i BE-së publikoi dhe shpërndau në shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese Ftesën për Propozime në lidhje me kandidatët për postet e Kryetarit dhe të gjykatësve të Dhomave të Specializuara.

Në pajtim me nenin 28 të Ligjit, u ngrit një panel i pavarur përzgjedhës (Paneli Përzgjedhës) për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve gjyqësorë për t'u caktuar si gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë (Regjistri), si dhe për dhënien e rekomandimeve për emërimin e Kryetarit dhe nënkryetarit të Dhomave të Specializuara.

Paneli Përzgjedhës përbëhej nga tre anëtarë: dy gjykatës ndërkombëtarë me përvojë të konsiderueshme në fushën e drejtësisë penale ndërkombëtare dhe një zyrtar i lartë ndërkombëtar. Kjo përbërje e Panelit Përzgjedhës siguroi vlerësimin e pavarur të kualifikimeve të secilit kandidat.

Shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese i paraqitën panelit përzgjedhës mbështetjen e tyre për një ose më shumë kandidatë që ata i mendonin të përshtatshëm.

Procesi përzgjedhës që vijoi konsistonte në një vlerësim të imtë të njohurive, ekspertizës dhe përvojës të kandidatëve që plotësonin kriteret dhe secili kandidat u intervistua në mënyrë individuale.

Mbi bazën e rekomandimeve të Panelit Përzgjedhës, më 14 dhjetor 2016, Shefja e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (Autoriteti Emërues) emëroi **Ekaterina Trendafilovën** si gjykatëse dhe Kryetare të Dhomave të Specializuara. Gjykatëse Trendafilova e mori detyrën më 12 janar 2017.

Më 7 shkurt 2017, në Regjistër u emëruan edhe 19 gjykatës të tjerë, ndër të cilët edhe nënkryetari Kith Rejnër (Keith Raynor). Njësoj si Kryetarja, edhe gjykatësit u emëruan nga Autoriteti Emërues. Asnjë prej gjykatësve nuk është i emëruar nga shtetet anëtare të BE-së, apo shtetet e treta kontribuuese.

Gjykatësit e emëruar vijnë nga një larmi fushash të drejtësisë. Disa kanë punuar në gjykata ose tribunale ndërkombëtare ose të ndërkombëtarizuar, ose në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Disa të tjerë kanë pasur karriera shumë të suksesshme në vendet e tyre, qoftë si gjykatës, avokatë mbrojtës, apo prokurorë. Ka edhe gjykatës me karrierë të shquar në fushën akademike. Të gjithë gjykatësit njihen për njohuritë e tyre të thella dhe ekspertizën unike në fushat e së drejtës penale, së drejtës humanitare dhe të drejtave të njeriut. Një nga gjykatësit është përzgjedhur posaçërisht për ekspertizën e tij në fushën e së drejtës administrative ndërkombëtare, për t'u konsideruar për caktim si gjykatës për Ankesat e Punonjësve të Dhomave të Specializuara, i cili merret me ankesat e punonjësve kundër vendimeve administrative dhe disiplinore (shih faqen 25).

Gjykatësit e emëruar janë shtetas të katërmbëdhjetë shteteve. Kjo përsëri tregon se ata janë përzgjedhur në bazë të meritave e jo në bazë të shtetësisë. Raporti gjinor në mes të njëzet gjykatësve (pesë femra, duke përfshirë Kryetaren, dhe pesëmbëdhjetë meshkuj) u përgjigjet kandidaturave të paraqitura dhe të mbështetura nga shte-

tet anëtare të BE-së dhe nga shtetet e treta kontribuuese. Sa i përket raportit të moshës, shtatë gjykatës janë të moshës nga 40 deri në 50 vjeç, shtatë të tjerë 51 deri në 60 vjeç, pesë 61 deri në 70 vjeç dhe një gjykatës është mbi 70 vjeç.



Kryetarja Ekaterina Trendafilova



Gjykatësja
Ekaterina Trendafilova
Kryetare (Bullgari)



Gjykatësi Keith Raynor
nënkryetar
(Britani e Madhe)

Gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese



Gjykatësi
Vidar Stensland
(Norvegji)



Gjykatësi
Roland Dekkers
(Holandë)



Gjykatësja
Ann Power-Forde
(Irlandë)



Gjykatësi
Antonio Balsamo
(gjykatës rezervë) (Itali)

Gjykatësit Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës



Gjykatësi
Charles L. Smith, III
(SHBA)



Gjykatësja Christine
Van den Wyngaert
(Belgjikë)



Gjykatësja
Michèle Picard
(Francë)



Gjykatësi
Thomas Laker
(Gjermani)



Gjykatësi
Emilio Gatti
(Itali)



Gjykatësi
Michael Bohlander
(Gjermani)



Gjykatësi
Kai Ambos
(Gjermani)



Gjykatësi
Kenneth Roberts
(Kanada)



Gjykatësja Mappie
Veldt-Foglia
(Holandë)



Gjykatësi
Christoph Barthe
(Gjermani)



Gjykatësi
Vladimir Mikula
(Republika Çeke)



Gjykatësi
Guénaél Mettraux
(Zvicër)



Gjykatësi
Nicolas Guillou
(Francë)




Gjykatësi
Andres Parmas
(Estoni)

Gjatë përzgjedhjes së gjykatësve për Dhomat e Specializuara të Kosovës, kandidatët u testuan me imtësi sa u përket njohurive, ekspertizës dhe përvojës së tyre si juristë – si gjykatës, prokurorë apo avokatë mbrojtës. Qëllimi i këtij procesi të rreptë përzgjedhës ishte që të emëroheshin profesionistët më të kualifikuar, pavarësisht nga përkatësia politike apo shtetësia e tyre.

Numri i gjykatësve nga shtetet anëtare të BE-se dhe nga shtetet e treta kontribuuese

Shtetet anëtare të BE-së

1	Bullgari (Kryetarja)
1	Britani e Madhe (nënkryetari)
1	Belgjikë
1	Republika Çeke
1	Estoni
2	Francë
4	Gjermani
1	Irlandë
2	Itali
2	Holandë




Shtetet e treta kontribuuese

1	Kanada
1	Norvegji
1	Zvicër
1	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Gjykatësit sipas grupmoshave

7	40-50 vjeç
7	51-60 vjeç
5	61-70 vjeç
1	70-75 vjeç



3 Instrumentet ligjore themelore

Me emërimin e Kryetares dhe të gjykatësve nisën përgatitjet për miratimin e tre instrumenteve ligjore të domosdoshme për funksionimin e Dhomave të Specializuara: Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja e Procedurës dhe e Provave); Kodi i Etikës Gjyqësore për Gjykatësit e Emëruar në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës (Kodi i Etikës Gjyqësore); dhe Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (Rregullorja për Caktimin). Këto instrumente janë në përputhje me Ligjin për DHSK-në dhe ZPS-në dhe e

plotësojnë atë. Brenda një muaji pas marrjes së detyrës nga Kryetarja, tri projektdokumentet e lartpërmendura u përgatitën dhe iu dërguan gjykatësve. Brenda dy javësh pas marrjes së tyre, gjykatësit dorëzuan komente dhe propozime gjithëpërfshirëse. Projektdokumentet e përditësuara u diskutuan në Plenaren e parë që u mbajt nga 14 deri më 17 mars 2017.

Gjatë Plenares së parë u miratuan dhe hynë në fuqi Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve dhe Kodi i Etikës Gjyqësore.



Plenarja e parë e gjykatësve të DSK-së - mars 2017



Rregullorja për Caktimin

Data e miratimit dhe hyrjes në fuqi: 14 mars 2017

Çfarë rregullon: bazën mbi të cilën Kryetarja i cakton gjykatësit në panele për procedura të caktuara.

Arsyetimi: miratimi i Rregullores për Caktimin parashihet në nenin 25 të Ligjit. Në këtë pikë-pamje, Rregullorja përbën risi sa i përket caktimit të gjykatësve ndërkombëtarë në çështje që kanë të bëjnë me krime ndërkombëtare.

Përmbajtja: Rregullorja për Caktimin përcakton që, në caktimin e gjykatësve në një procedurë të caktuar në Dhomat e Specializuara të Kosovës, Kryetarja niset nga kritere objektive si përvoja, ekspertiza, vjetërsia në punë, gjinia dhe përfaqësimi gjeografik, si dhe nga parapëlqimet e gjykatësve dhe disponueshmëria e tyre në kohën e fillimit të procedurave përkatëse (rregulla 4(2) e Rregullores për Caktimin). Kryetarja nxjerr një vendim publik të caktimit të gjykatësve në një trup gjykues ku përvijon kriteret për caktimin përkatës. Gjykatësit kanë detyrimin ta informojnë Kryetaren për çdo angazhim, veprimtari ose çështje tjetër që mund të ndikojë në caktimin e tyre në të ardhmen në trupin gjykues për një çështje të caktuar.

Ku gjendet: Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve është dokument publik dhe mund të lexohet në faqen e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Internet.

Kodi i Etikës Gjyqësore

Data e miratimit dhe hyrjes në fuqi: 14 mars 2017

Çfarë rregullon: standardet e etikës profesionale të gjykatësve dhe regjimin e zbatueshëm disiplinor për gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Arsyetimi: Kodi i Etikës Gjyqësore bazohet në nenin 27 të Ligjit i cili kërkon që gjykatësit të jenë persona me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe me integritet.

Përmbajtja: Kodi i Etikës Gjyqësore vendos standardet profesionale më të larta të pavarësisë, paanshmërisë, ndershmërisë dhe zellit për gjykatësit e Dhomave të Specializuara gjatë kryerjes së funksioneve të tyre. Në të përfshihen edhe dispozita të tjera në lidhje me detyrimin e konfidencialitetit, sjelljen e njerëzishme gjatë procedurave, respektimin e anëtarëve të stafit dhe të pjesëmarrësve në procedura dhe komunikimin me mediat. Ai parasheh gjithashtu masat disiplinore në rast të sjelljeve kundërvajtëse. Kodi përcakton “sjelljet kundërvajtëse të rënda” dhe “sjelljet kundërvajtëse më pak të rënda” dhe parashikon një procedurë të hollësishme për çdo pretendim të tillë, si dhe masat disiplinore që mund të merren, ndër të cilat edhe përjashtimi nga Regjistri.

Ku gjendet: Kodi i Etikës Gjyqësore është dokument publik dhe mund të lexohet në faqen e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Internet.

Pas miratimit të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve dhe Kodit të Etikës Gjyqësore, Plenarja vazhdoi punën me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave. Në pajtim me nenin 19(1) të Ligjit, katër gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK) nuk morën pjesë në diskutimin dhe miratimin e këtij dokumenti. Në vend të kësaj, ata u mbledhën për të diskutuar Rregulloren e Punës së DHSGJK-së, e cila, sipas nenit 49 të Ligjit, miratohet vetëm nga gjykatësit e DHSGJK-së dhe përfshihet në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Në përgatitjen e Rregullores së Procedurës dhe të Provave, gjykatësit iu përmbajtën Ligjit me synimin për ta plotësuar atë, duke mundësuar njëkohësisht që Rregullorja të ishte në përputhje të plotë me tekstin dhe frymën e Kushtetutës së Kosovës dhe me standardet më të larta të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës gjithashtu shërbeu si burim orientues për gjykatësit. Krahas këtyre instrumenteve ligjore, gjykatësit konsultuan edhe rregulloret procedurale të tribunalëve të mëparshëm *ad hoc* dhe të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, si dhe u mbështetën në mësimet e nxjerra nga praktikatat e punës së tyre. Po kështu, gjatë hartimit të Rregullores, vëmendje iu kushtua edhe traditës dhe praktikës ligjore në Kosovë për të siguruar që procedurat të mund të përcillen dhe kuptohen lehtë nga popullata e Kosovës.

Pas një diskutimi treditör, më 17 mars 2017, Plenarja miratoi Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Rregullores së Procedurës dhe të Provave

Në përputhje me Ligjin, Rregullorja e miratuar e Procedurës dhe e Provave iu nënshtrua një shqyrtimi të gjithanshëm nga ana e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, për të vendosur mbi përputhshmërinë e saj me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës.

Kapitulli II i Kushtetutës së Kosovës

Kapitulli II i Kushtetutës parashtron të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura dhe të garantuara në Kosovë. Ndër të tjera, të mishëruara në këtë kapitull janë: parimi i barazisë përpara ligjit, e drejta për jetë, e drejta për liri dhe siguri, të drejtat e të akuzuarve, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta për mjete ligjore.

Neni 31 garanton të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Paragrafi 2 i këtij neni thotë:

“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

Pas miratimit, Kryetarja ia referoi Rregulloren e Procedurës dhe të Provave DHSGJK-së që në bazë të Ligjit duhej të nxirrte vendimin përkatës brenda tridhjetë ditësh. Pas një shqyrtimi të imtësishëm të Rregullores së miratuar të Procedurës dhe të Provave, më 26 prill 2017, DHSGJK-ja

nxori aktvendimin në të cilin konstatohej se nëntë prej 208 rregullave nuk ishin në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës, ndërsa për një të tjerë prej dispozitave DHSGJK-ja nuk mund të nxirrte përfundim.

Ndër të tjera, DHSGJK-ja konstatoi se një prej rregullave nuk ishte në përputhshmëri me Kushtetutën sepse parashikonte mundësinë e mbajtjes së seancave në mungesë të njërit prej tre gjykatësve të një trupi gjykues (për shkak sëmundjeje ose për arsye personale), për një periudhë prej jo më shumë se pesë ditësh. Synimi i hartimit të kësaj dispozite nga Plenarja – dispozitë që përdoret edhe në procedura të tjera penale ndërkombëtare – ishte respektimi i së drejtës së të akuzuarve për t'u gjykuar pa vonesa të panevojshme. Sidoqoftë, DHSGJK-ja arriti në përfundimin se gjykimi para dy gjykatësve dhe jo para një paneli të plotë nuk përbën gjykim “para një gjykate të themeluar me ligj”, siç parashihet në Kushtetutë.

DHSGJK-ja konstatoi gjithashtu se një numër dispozitash që rregullojnë masat hetimore të posaçme nga ana e Prokurorit të Specializuar duhet të jenë më konkrete dhe të kenë më shumë garanci mbrojtëse për sigurimin e të drejtave të individëve të garantuara në kushtetutë.

Po ashtu, DHSGJK-ja shpalli jokushtetuese rregullën që parashikonte mundësinë e mbajtjes në paraburgim të një personi të shpallur të pafajshëm nga trupi gjykues ndërkohë që shqyrtohet apeli i Prokurorisë kundër vendimit të pafajësisë. Ndonëse kjo qasje njihet edhe në gjykata të tjera penale ndërkombëtare, DHSGJK-ja konstatoi se kjo ishte në mospërputhje me Kushtetutën sepse nuk parashihet në Ligji dhe nuk përbën një prej arsyeve të lejueshme për heqje të lirisë.



Kryetarja e panelit të DHSGJK-së, Ann Power Forde, shpall vendimin në transmetim në kanal YouTube të DSK-së - 26 prill 2017

“Gjykata pajtohet me pikëpamjen e GJEDNJ-së për nenin 5(1) të Konventës dhe thekson rëndësinë parësore të së drejtës për liri në një shoqëri demokratike, lidhjen e kësaj të drejte me konceptin e shtetit ligjor dhe me parimet e qartësisë dhe proporcionalitetit të ligjit, si edhe qëllimin e përgjithshëm të kësaj të drejte që është të sigurojë që askush të mos privohet nga liria në ‘mënyrë arbitrare’.”

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, 26 prill 2017, para. 197

Sikurse parashihet prej Ligjit, rregullat për të cilat u konstatua se ishin në mospërputhje me Kushtetutën iu kthyen përsëri gjykatësve në Plenare për shqyrtim të dispozitave përkatëse. Si rrjedhojë, në maj 2017, gjykatësit mbajtën një Plenare të dytë përmes mjeteve elektronike duke mos qenë të pranishëm fizikisht, për diskutimin e rregullave në fjalë dhe miratimin e një versioni të rishikuar të tyre.

Rregullat e rishikuara iu referuan përsëri DHSGJK-së për një shqyrtim të ri. Më 28 qershor 2017, DHSGJK-ja vendosi se asnjë prej rregullave të rishikuara nuk ishte në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës. Për rrjedhojë, DHSGJK-ja konstatoi se të gjitha rregullat e Rregullores së Procedurës dhe të Provave i përmbushnin kriteret e Kapitullit II të Kushtetutës.

Hyrja në fuqi e Rregullores së Procedurës dhe të Provave

Pas shqyrtimit rrënjësor dhe vendimit të DHSGJK-së, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave hyri në fuqi më 5 korrik 2017. Përpilimi, diskutimi dhe miratimi i Rregullores së Procedurës dhe të Provave, si dhe dy shqyrtimet nga ana e DHSGJK-së, u kryen në më pak se gjashtë muaj nga emërimi i gjykatësve të cilët morën parasysh praktikën më të mira gjyqësore dhe përfshinë zgjidhje novatore që synonin kryerjen me efikasitet dhe shpejtësi të procedurave në Dhomat e Specializuara.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së Procedurës dhe të Provave në korrik 2017, Dhomat e Specializuara të Kosovës u bënë **tërësisht funksionale në aspektin gjyqësor**, të afta të marrin parashtrime të çdo lloji dhe të kryejnë procedura penale.

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave

Data e miratimit: 17 mars 2017

Data e hyrjes në fuqi: 5 korrik 2017

Çfarë rregullon: kryerjen e procedurave në të gjitha nivelet e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Arsyetimi: duke qenë se në DHSK janë të zbatueshme vetëm ato dispozita të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës që cekën posaçërisht në Ligj, ky i fundit parashihet miratimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave për rregullimin ligjor të kryerjes së procedurave. Rregullorja e Procedurës dhe e Provave duhet të pasqyrojë "standardet më të larta të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (MNDCP), me synim garantimin e shqyrtimit gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë, duke marrë parasysh natyrën, vendin dhe specifikat e procedurës që shqyrtohet nga Dhomat e Specializuara" (neni 19(2) i Ligjit).

Përmbajtja: Rregullorja e Procedurës dhe e Provave parashikon, ndër të tjera, procedurën për shqyrtimin dhe konfirmimin e aktakuzave, nxjerrjen e materialeve, paraqitjen, pranimin dhe vlerësimin e provave, diskutimin dhe shpalljen e aktgjykimeve, pjesëmarrjen e viktimave dhe çështje që lidhen me bashkëpunimin me autoritetet e Kosovës dhe shtetet e treta. Rregullorja gjithashtu parashikon një sistem solid për mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave dhe personave të tjerë në rrezik si rrjedhojë e bashkëpunimit të tyre me DHSK-në ose për shkak të dëshmi të dëshmitarëve. Rregullorja e Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese përfshihet në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave dhe rregullon me ligj procedurat para asaj Dhome.

Ku gjendet: Rregullorja e Procedurës dhe e Provave është publike dhe mund të lexohet në faqen e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Internet.

4 Krijimi i kornizës procedurale

Hyrja në fuqi e Rregullores së Procedurës dhe të Provave krijoi bazën ligjore për miratimin e instrumenteve të tjera që rregullojnë kryerjen e procedurave dhe funksionimin e përgjithshëm të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Për funksionimin normal të DHSK-së, nevojitet edhe një numër i madh instrumentesh procedurale që rregullojnë aspekte të ndryshme, më teknike, të procedurave. Ndër to përfshihen udhëzues në lidhje me parashtrimet dhe procedurat konkrete që duhen ndërmarrë gjatë procesit gjyqësor, udhëzues për funksionimin e brendshëm të njësive të ndryshme, dhe direktiva e rregullore të tjera.

Ndërsa disa prej këtyre instrumenteve tashmë janë miratuar, disa të tjerë janë në proces diskutimi dhe hartimi me synim miratimin e tyre në një të ardhme të afërt. Ndër to janë Kodi i Etikës Profesionale, Udhëzuesi për Dorëzimin e Parashtrimeve dhe Udhëzuesi për Komisionin e Rregullores.

Ndonëse shumë prej këtyre instrumenteve janë miratuar ose do të miratohen nga Administratorja, shumë prej tyre përfshihen në përgjegjësitë administrative gjyqësore të Kryetares dhe duhet të miratohen prej saj.

Për shembull, **Rregullorja e Procedurës për Ankesat e Punonjësve** (miratuar nga Kryetarja më 11 shtator 2017) rregullon kryerjen e procedurave ankimore (të punonjësve, ish-punonjësve ose personave që bëjnë ankesa në emër të punonjësve që kanë humbur aftësitë ose që nuk jetojnë më) kundër vendimeve të Administratores dhe masave disiplinore (të dhëna nga Administratorja ose Prokurori i Specializuar). Qëllimi i Rregullores së Procedurës për Ankesat e Punonjësve është të garantojë përfaqësim të barabartë të pikëpamjeve të personave ankues, të Administratores ose Prokurorit të Specializuar, si dhe të jepet zgjidhje e shpejtë për çdo çështje nga ana e gjykatësit për ankesat e punonjësve, në pajtim me kërkesat e procesit të bazuar në ligj.

Një dokument tjetër i rëndësishëm i miratuar nga Kryetarja dhe lëshuar nga Administratorja më 6 nëntor 2017 është **Direktiva për Mbrojtësit**, e cila përcakton kriteret e pranueshmërisë, të procesit të aplikimit dhe pranimit të mbrojtësve në Listën e Mbrojtësve të Specializuar (për të akuzuarit dhe të dyshuarit) dhe të Mbrojtësve të Viktimave. (shih faqen 41).

5 Marrëdhëniet e jashtme

Në rolin e saj si Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës, gjykatësja Ekaterina Trendafilova ka zhvilluar një numër të madh takimesh dypalëshe me përfaqësues të komunitetit diplomatik në Hagë dhe Bruksel, me qëllim sigurimin e mbështetjes së nevojshme dhe bashkëpunimit të tyre me Dhomat e Specializuara të Kosovës. Në qershor 2017, Kryetare Trendafilova e informoi Komitetin Politik dhe për Siguri të BE-së për zhvillimet dhe arritjet

kyçe gjatë periudhës që nga emërimi i saj, ku theksoi se në më pak se pesë muaj nga emërimi i gjykatësve, ishin miratuar instrumentet kyçe ligjore që i bënë Dhomat e Specializuara tërësisht funksionale në aspektin gjyqësor. Përfaqësuesit e shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve të treta kontribuuese u informuan përsëri për zhvillimet kyçe në dhjetor 2017.

Komunikimi dhe ndërgjegjësimi

Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim ka rol qendror në Dhomat e Specializuara të Kosovës, në Kosovë dhe gjetiu. Të vetëdijshme për mësimet e nxjerra në lidhje me rajonin, Dhomat e Specializuara të Kosovës synojnë të jenë të hapura dhe të ndërveprojnë në mënyrë dinamike me komunitetet e prekura nga krimet e pretenduara të përfshira në juridiksionin e tyre.

Meqenëse DHSK-ja po bëhet gjithnjë e më e dukshme dhe më e diskutuar në media, është me rëndësi jetike që ky institucion të mundësojë një kuptim më të mirë të mandatit dhe punës së vet, të krijojë besim në procesin gjyqësor dhe të tregojë se vendos drejtësi në mënyrë të paanshme dhe të pavarur.

Për këtë arsye, është krijuar një program komunikimi dhe ndërgjegjësimi i kalibruar mirë dhe me shtrirje të gjerë që përfshin konsultime të shpeshta me organizata, seanca informuese për gazetarë, programe për studentë, takime me qytetarë, tryeza të rrumbullakëta, dhe përditësime të rregullta përmes buletineve. Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim bashkërendohet nga Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJIKP), qëllimi i të cilit është të ofrojë informacione të përditësuara dhe të nxisë dialogun në lidhje me punën e Dhomave të Specializuara (shih faqen 37). Nëpërmjet angazhimit dhe komunikimit aktiv me organizata të shoqërisë civile dhe komunitetet e tjera në Kosovë, DHSK-ja synon t'u bëjë ballë disa prej sfidave në komunikim që lidhen me administrimin e proceseve të zhvendosura.

Disa veprimtari të programit për komunikim dhe ndërgjegjësim

- Takime konsultative të shëfës së NJIKP-së me shoqërinë civile – Prishtinë, prill 2016
- Vizita të Administratores dhe shëfës së NJIKP-së në Kosovë – korrik/tetor 2016
- Takime konsultative të shëfës së NJIKP-së me shoqërinë civile – Prishtinë, janar 2017
- Forumi për Transparencë në Drejtësi – Prishtinë, prill 2017
- Vizitë e një grupi organizatash joqeveritare në selinë e DHSK-së – Hagë, maj 2017
- Takime konsultative me shoqërinë civile – Prishtinë, tetor 2017
- Veprimtari informuese e Kryetares dhe Administratores me shoqërinë civile – Prishtinë, 23 nëntor 2017
- Prezantim nga zëvendësadministratori dhe shëfja e NJIKP-së për gazetarë nga Ballkani “Integrimi Euro-Atlantik i Ballkanit Perëndimor” - Hagë, dhjetor 2017
- Takime konsultative me shoqërinë civile të koordinatorit të Zyrës së Mbrojtjes dhe shëfës të Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave – Prishtinë, shkurt 2018
- Takim i koordinatorit të Zyrës së Mbrojtjes dhe shëfës së Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave me anëtarë të Odës së Avokatëve të Kosovës – Prishtinë, shkurt 2018

Falë zemërgjerësisë së qeverisë së Zvicrës nëpërmjet dhurimit të një fondi, gjatë dy viteve të ardhshme Dhomat e Specializuara të Kosovës do të fuqizojnë qenësisht veprimtarinë dhe praninë e tyre në Kosovë. Ky kontribut do të sigurojë vazhdimin e punës me palët e interesuara në nivel vendor dhe rajonal dhe do të ndihmojë dialogun me qytetarët e Kosovës dhe shoqërinë civile.



Administratorja dhe shefja e NJIKP-së në Forumin për Transparencë në Drejtësi në Prishtinë - prill 2017



Zëvendësadministratori, shefja e Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave dhe koordinatori i Zyrës së Mbrojtjes, duke folur me shoqërinë civile në Prishtinë - tetor 2017



Kryetarja, Administratorja dhe Prokurori i Specializuar në konkursin e Simulimit Gjqësor të GJPN-së - maj 2017

Administratorja në Forumin për Transparencë në Drejtësi

Administratorja dhe shefja e Njesisë për Informim dhe Komunikim me Publikun mbajtën një seancë informuese me pjesëtarë të shoqërisë civile dhe të mediave në Kosovë.

Si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) për rritjen e transparencës në gjyqësorin e Kosovës, kjo veprimtari u mundësoi pjesëmarrësve të njihen më mirë me funksionimin, mandatin, dhe planet e punës së DHSK-së. Kjo u ndoq nga një seancë me pyetje dhe përgjigje për aspekte të detajuara të punës të DHSK-së.

Konsultimi i DHSK-së me organizatat e shoqërisë civile kosovare

Më 11 tetor 2017, zëvendësadministratori, koordinatori i Zyrës së Mbrojtjes, shefja e Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave dhe shefja e Njesisë për Informim dhe Komunikim me Publikun mbajtën një takim me organizata të ndryshme të shoqërisë civile në Qendrën e Dokumentimit në Prishtinë (administruar prej Fondit për të Drejtën Humanitare). Ky takim ofroi një platformë të rëndësishme për vijimësinë e dialogut midis DHSK-së dhe komuniteteve e palëve të ndryshme në Kosovë.

Që nga prilli i vitit 2016, DHSK-ja ka zhvilluar rregullisht takime konsultative me organizata joqeveritare dhe pjesëtarë të tjerë të shoqërisë civile në Kosovë.

Kryetarja, Administratorja dhe Prokurori i Specializuar në Qendrën Grotius për Studime Juridike Ndërkombëtare

Më 17 maj 2017, Kryetarja, Administratorja dhe Prokurori i Specializuar mbajtën prezantime para afërsisht 300 juristëve dhe studentëve në Qendrën Grotius për Studime Juridike Ndërkombëtare të Fakultetit Juridik të Leidenit. Kjo veprimtari u zhvillua krahas Simulimit Gjqësor për Studentë në Gjykatën Penale Ndërkombëtare, mbajtur në Hagë. Veprimtarinë e drejtoi Carsten Stahn, profesor i të drejtës penale ndërkombëtare. Pas prezantimeve të Kryetares, Administratores dhe Prokurorit të Specializuar vijoi një seancë pyetje-përgjigjesh.

Vizita e parë e Kryetares në Kosovë

Nga 22 deri më 25 nëntor 2017, Kryetarja, e shoqëruar nga Administratorja, ndërmori vizitën e saj të parë zyrtare në Kosovë. Dy drejtueset e larta u takuan me Ministrin e Drejtësisë së Kosovës, z. Abelard Tahiri, Avokatin e Popullit, z. Hilmi Jashari, dhe kryetarin e Odës së Avokatëve të Kosovës, z. Osman Havolli.

Ato gjithashtu mbajtën takime dypalëshe me përfaqësues të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Një ndihmesë të madhe gjatë kësaj vizite dha edhe Përfaqësuesja e Posaçme e BE-së në Kosovë, Natalia Apostolova, e cila priti, organizoi dhe drejtoi takimet me përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve të treta kontribuuese.

Në qendër të kësaj vizite të parë në Kosovë ishte një veprimtari informuese për shoqërinë civile e cila u pasqyrua drejtpërsëdrejti nga mediat në mbarë Kosovën – veprimtari që u prit shumë mirë dhe pati pjesëmarrje të gjerë. Kryetarja dhe Administratorja folën për strukturën dhe punën e Dhomave të Specializuara dhe zhvilluan një dialog aktiv me pjesëmarrësit. Pasi vuri në dukje disa nga përparësitë kryesore të Dhomave të Specializuara të Kosovës, si mundësimi i një sistemi të fuqishëm për mbrojtjen e dëshmitarëve, pjesëmarrja e qenësishme e viktimave dhe përfaqësimi efektiv i të akuzuarve, Kryetarja i siguroi edhe një herë pjesëmarrësit për përkushtimin e të gjithë gjykatësve për dhënien e shembujve të praktikave më të mira gjyqësore dhe për afirmimin e DHSK-në si një institucion solid, i sigurt, i besueshëm, dhe i drejtë.

Gjatë vizitës së saj Kryetarja theksoi në mënyrë të përsëritur një numër porosish themelore për popullatën e Kosovës si: dallimin ndërmjet Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar; konceptin e përgjegjësisë penale individuale të mishëruar në Ligj përkundrejt pretendimit se janë vënë në shënjestër grupe apo organizata të caktuara; detyrimi dhe vendosmëria e Dhomave të Specializuara të Kosovës për kryerjen e gjykimeve të drejta, të pavarura, të paanshme, të sigurt dhe të shpejta.

Kontaktet me studentë dhe juristë

Programi për Vizitorë i DHSK-së, i krijuar në vitin 2016, ka krijuar mundësi për studentë dhe grupe të tjera të vizitojnë selinë e Dhomave të Specializuara të Kosovës. Gjatë këtyre vizitave, përfaqësues të Dhomave të Specializuara të Kosovës të Zyrës së Prokurorit të Specializuar u



Kryetarja dhe Administratorja në takimim me shoqërinë civile në Prishtinë - nëntor 2017

flasin vizitorëve për punën e tyre. Në emër të Dhomave, Kryetarja, shefi i kabinetit të saj dhe juristë flasin rregullisht me studentë dhe grupe të tjera që vizitojnë mjediset e DHSK-së. Në emër të Zyrës Administrative, të ftuarve u flasin edhe Administratorja, zëvendësadministratori, këshilltarja juridike, ose punonjës të tjerë.

Gjatë viteve 2016 dhe 2017 në këtë program morën pjesë rreth 400 studentë nga katërbëdhjetë universitete të ndryshme nga Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vizitorëve u jepet mundësia të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë tema me interes.

Kryetarja, Administratorja dhe përfaqësues të tjerë të Dhomave të Specializuara të Kosovës kanë mbajtur gjithashtu edhe ligjërata dhe fjalime për punën e DHSK-së në universitete të ndryshme, duke u dhënë kështu brezave të rinj të juristëve informacione për punën dhe mandatin e institucionit.

Programi për Vizitorë i DHSK-së (djathtas) Kryetarja, Administratorja dhe Prokurori i Specializuar ligjërojnë në mjediset e Universitetit të Leidenit në Hagë me rastin e konkursit të simulimit gjyqësor për studentë të organizuar nga GJPN - maj 2017 (poshtë)



Kontaktet me mediat

Kryetarja është angazhuar aktivisht me mediat kosovare dhe ndërkombëtare. Në maj 2017 ajo mbajti konferencën e parë për shtyp në Hagë ku i informoi gazetarët e pranishëm për arritjet kryesore. Kryetarja është intervistuar edhe nga disa organe të mediave.

Pjesë nga intervistat e Kryetares Trendafilova

Çfarë ndryshimi ka kjo gjykatë nga të tjerat dhe si do ta mundësoni ju si gjykatëse përmbushjen e mandatit prej gjykatës?
Dhomat e Specializuara u krijuan nëpërmjet një amendamenti kushtetues që u miratua nga Kuvendi i Kosovës me një shumicë dy të tretash. [...]

Në Dhomat e Specializuara mund të gjykojnë vetëm gjykatës ndërkombëtare. Kjo zgjedhje tregon se Kuvendi i Kosovës tregoi konsideratën më të lartë për pavarësinë dhe integritetin e këtij institucioni, procedimet penale që do të kryhen në këtë



Kryetarja Ekaterina Trendafilova duke biseduar me gazetarë të Reuters-it

institucion dhe për sigurinë e viktimave dhe dëshmitarëve (BIRN, 2017).

Çfarë përgjigje keni ndaj kritikave se Dhomat e Specializuara janë të njëanshme sepse merren vetëm me një grup etnik, shqiptarët e Kosovës?

Dhomat e Specializuara nuk kryejnë ndjekje penale të asnjë grupi etnik, apo organizate. Dhomat e Specializuara do të procedojnë penalisht dhe do të shpallin fajtorë vetëm individë. Ligji (për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar) përcakton qartësisht përgjegjësinë penale individuale, që do të thotë se individët do të shpallen fajtorë për vepra penale që kanë kryer si individë dhe jo si pjesëtarë të një grupi apo bashkësie etnike apo të çfarëdo grupi tjetër (BIRN, 2017).

Si do të siguronit efikasitetin e punës së gjykatës?

Në miratimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave gjykatësit e Dhomave të Specializuara kanë mbajtur parasysh parimet e drejtësisë, shpejtësisë, paanësisë dhe sigurisë. Janë caktuar afate kohore të rrepta si për fazat e ndryshme të procedurave, ashtu dhe për ushtrimin e detyrave, përfshirë edhe dhënien e vendimeve dhe aktgjykimeve. [...] Për më tepër, Rregullorja përmban detyrimin që gjykatësit dhe palët të administrojnë dhe organizojnë në mënyrë efektive kryerjen e procedurave. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësit, ndër të cilët edhe unë, janë shumë të interesuar t'i bëjnë efektive dhe të shpejta procedurat e Dhomave të Specializuara. Gjithsesi, efikasiteti dhe shpejtësia nuk duhet të dëmtojnë të drejtat themelore të askujt nga personat e përfshirë në proces – të dyshuarve, të akuzuarve, viktimave dhe dëshmitarëve (Kosova Sot, 2017).

A ka persona në Kosovë, si për shembull politikanët, që kanë imunitet para kësaj gjykate?

Askush nuk ka imunitet pavarësisht nga pozita e tyre, as amnistia nuk është e mundshme (Reuters, 2017).

Zyra Administrative

Zyra Administrative e drejtuar nga Administratorja, ushtron një sërë funksionesh mbështetëse administrative dhe gjyqësore. Sipas nenit 34 të Ligjit, Zyra Administrative është përgjegjëse për shërbimet që lidhen me funksionimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe të gjitha funksionet e ndërlidhura të nevojshme. Këtu përfshihet edhe dhënia e mbështetjes administrative për punën e Dhomave dhe të ZPS-së në fushën e buxhetit, financave, prokurimit, burimeve njerëzore, dhe sigurisë. Funksionet e mbështetjes gjyqësore



Dr. Fidelma Donlon, Administratore e DSK-së

përfshijnë mbështetje dhe mbrojtje për dëshmitarët administrimin e ndihmës juridike dhe të sistemeve të pjesëmarrjes së viktimave, përkthimet me gojë dhe me shkrim, si dhe administrimin e gjykatës. Administratorja është gjithashtu përgjegjëse për administrimin e objekteve të paraburgimit të DSK-së, si dhe funksione të tjera të jashtme diplomatike, përfshirë dhe negociimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shtetet.

Dr. Fidelma Donlon u emërua në postin e Administratores, në prill 2016. Para kësaj, dr. Donlon ishte drejtuese e Ekipit për Planifikimin e Gjykatës. Përpara krijimit zyrtar të Zyrës Administrative në prill 2016, Ekipi për Planifikimin e Gjykatës kishte bërë një punë të konsiderueshme që i hapi rrugën fillimit të veprimtarisë së Zyrës Administrative në shtetin pritës dhe u mundësoi Dhomave të Specializuara të intensifikonin krijimin e kapaciteteve. Zëvendësadministratori, dr. Guido Acquaviva, e ndihmon Administratoren në funksionet e saj.

Që në pikënisje të punës, Administratorja përpiloi dhe udhëhoqi planin strategjik dhe afatet për krijimin e kapaciteteve logjistike, administrative, juridike dhe gjyqësore të DSK-së. Në emër të Zyrës Administrative dhe në cilësinë si përgjegjëse për administrimin e procedurave gjyqësore të zhvendosura, Administratorja nënshkruan marrëveshjet e subvencionimit me Komisionin Evropian që rregullojnë financimin e DSK-së dhe ZPS-së. Ajo siguron që fondet e livruara për këtë qëllim nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese të administrohen me kursim dhe efikasitet në mbështetje të punës efektive të DSK-së dhe ZPS-së.

Sipas Marrëveshjes me Shtetin Pritës, Administratorja përfaqëson institucionet e zhvendosura (DHSK-në dhe ZPS-në) në Holandë. Në këtë cilësi, ajo është në kontakt të vazhdueshëm me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës, Ministrinë e Drejtësisë dhe Sigurisë të Holandës, Shërbimin e Burgjeve të Holandës dhe autoritetet vendore të qytetit të Hagës. Administratorja gjithashtu kultivon dialogun diplomatik me shtetet anëtare të BE-së, shtetet e treta kontribuuese dhe shtetet e tjera të komunitetit diplomatik në Hagë, për çështje lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit me Zyrën Administrative. Ajo bashkëpunon gjithashtu me Misionin për Sundimin e Ligjit të

BE-së në Kosovë, Përfaqësuesen e Posaçme të BE-së në Kosovë, pjesëtarët e komunitetit diplomatik në Kosovë, dhe Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës. Administratorja e viziton rregullisht Kosovën.

Zyra Administrative përbëhet nga Kabineti i Administratores, Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun, Zyra e Auditimit, si dhe dy seksione – Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore dhe Seksioni i Administratës. Po kështu, për qëllime administrative, në Zyrën Administrative përfshihet edhe Zyra e pavarur e Avokatit të Popullit.

1 Kabineti i Administratores (KA)

KA-ja mbështet punën e Administratores dhe zëvendësadministratorit, përfshirë dhënien e këshillave juridike lidhur me mandatin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe procedurat administrative, si dhe komunikimet me shtetin pritës, Shërbimin e Jashtëm të BE-së, misionet diplomatike dhe organizatat e tjera. KA-ja është gjithashtu përgjegjëse për rregullimin ligjor dhe mbikëqyrjen e rregulloreve për administrimin e sistemit të informacionit në Dhomat e Specializuara.

Që nga krijimi i Zyrës Administrative, në sajë të punës së KA-së janë miratuar një numër i konsiderueshëm **rregullash dhe aktesh nënligjore** të nevojshme për administrimin dhe mbështetjen efektive të procedurave.


Këshilltari juridik në KA ofron këshilla juridike të pavarura për zbatimin e Marrëveshjes me Shtetin Pritës, Rregulloren e Personelit, Kodin e Sjelljes për Punonjësit, privilegjet dhe imunitetet,

bashkëpunimin me shtetet, rregulloret e Zyrës Administrative për drejtimin administrativ, dhe çështje të tjera.

KA-ja gjithashtu ndihmon Administratoren në **marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e jashtëm** me përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së, shteteve të treta kontribuuese dhe pjesëtarë të tjerë të komunitetit diplomatik në Kosovë dhe në Hagë. Po ashtu, KA-ja ndihmon Administratoren në marrëdhëniet me Shërbimin e Jashtëm të BE-së dhe Komisionin Evropian për çështje administrative që kanë të bëjnë me Marrëveshjen për Subvencionim.

Në përputhje me përparësinë që i jep Zyra Administrative administrimit të sigurt të informacionit, **Njësia e Administrimit të Informacionit (AdInf)** në kuadër të KA-së, ofron këshilla për administrimin e të dhënave dhe arkivave digjitale, fizike dhe audiovizuale, si dhe

STRUKTURA E ZYRËS ADMINISTRATIVE



Administratorja ka miratuar:

- **Rregulloren e Personelit;**
- **Kodin e Sjelljes** për Punonjësit (Shtojcë e Rregullores së Personelit);
- **Direktivën për Mbrojtësit;**
- **25 Direktiva Administrative, 14 Udhëzime Operative dhe 7 Qarkore Informative** në fushat e administrimit të personelit, sigurisë, sigurisë së informacionit, objekteve të pronësisë, teknologjisë informative, financave, dhe prokurimit.

për respektimin e standardeve për mbrojtjen e të dhënave. AdInf ka krijuar praktika, udhëzime dhe procedura për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave në nivel të mbarë organizatës, duke mundësuar që DHSK-ja të përmbushë të gjithë kriteret e sigurisë së informacionit. AdInf mbikëqyr zbatimin e praktikave, udhëzimeve dhe procedurave në të gjitha njësitë.

Gjithashtu, AdInf ka krijuar rrjetin e brendshëm të Internetit dhe bibliotekën e Dhomave të Specializuara të Kosovës. Shërbimi bibliotekar përfshin edhe huazime nga biblioteka të tjera me ndërmjetësimin e Bibliotekës së Pallatit të Paqes në Hagë.

Siguria e Informacionit

- AdInf bashkërendon të gjitha aspektet e programit të sigurisë së informacionit për ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit, dhe disponueshmërisë së të gjithë dokumentacionit.
- Qasja në të dhëna bazohet rreptësisht në parimin 'vetëm për ata që duhet të dinë'.
- I gjithë dokumentacioni është sekret dhe i mbrojtur në atë shkallë që i përgjigjet nivelit të ndjeshmërisë dhe dëmit të mundshëm që mund shkaktojë nxjerrja e paautorizuar e tij.

2 Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJIKP)

NJIKP-ja bashkërendon komunikimet e jashtme dhe programin për komunikim dhe ndërgjegjësim të Dhomave të Specializuara të Kosovës në përputhje me strategjinë për komunikim të DHSK-së. Synimi i kësaj njësie është shtimi i njohurive dhe ndërgjegjësimi gjithnjë e më i madh për punën dhe mandatin e DHSK-së dhe mundësimi i një dialogu të vazhdueshëm me faktorët vendorë në Kosovë dhe në rajon.

NJIKP-ja fuqizon komunikimin e drejtpërdrejtë me shoqërinë kosovare përmes një rrjeti informues që përfshin shoqërinë civile, rininë, profesionistët në fushën e ligjit, mediat e të tjerë. Përmes një angazhimi aktiv me publikun në Kosovë dhe në nivel ndërkombëtar, NJIKP-ja synon t'u përgjigjet



Fletinformacione të DHSK-së

disa prej vështirësive të komunikimit që lidhen me administrimin e proceseve të zhvendosura.

Për të arritur një shtrirje sa më të gjerë, NJIKP-ja bashkërendon marrëdhëniet e DHSK-së me mediat, u përgjigjet çdo ditë kërkesave të mediave për informacion, si dhe organizon konferenca për shtyp, veprimtari informuese dhe kryen anketime. NJIKP-ja ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për mandatin dhe procedurat para DHSK-së përmes një faqeje interneti në tri gjuhë, fletinfor-

macioneve dhe kanalit të DHSK-së në YouTube. Gjithashtu, NJIKP-ja organizon dhe drejton edhe Programin e Vizitorëve me qendër në Hagë për studentë dhe grupe të tjera të interesuara. Gjatë periudhës së raportimit, NJIKP-ja është përqendruar në intensifikimin sa më të madh të komunikimit dhe ndërgjegjësimit të komuniteteve të prekura në Kosovë, të shoqërisë civile dhe medias, si edhe ka mbështetur marrëdhëniet me mediat dhe veprimtaritë për komunikim dhe ndërgjegjësim të Kryetares dhe Administratorës.



Shefja e NJIKP-së duke folur në takimin me Rrjetin e Grave të Kosovës në Prishtinë - 2018

3 Zyra e Auditimit

Audituesi i brendshëm kontribuon në administrimin dhe llogaridhënien institucionale përmes kryerjes së auditimeve të brendshme dhe raportimit të Administratorja. Audituesi u përmbahet standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe

rregulloreve financiare të BE-së dhe propozon masa për një administrim më të mirë të punës. Në Zyrën Administrative dhe në ZPS kryhen rregullisht auditime të financave, prokurimit dhe të administrimit të personelit.

4 Zyra e Avokatit të Popullit

Zyra e Avokatit të Popullit është një përbërës i rëndësishëm i Dhomave të Specializuara të Kosovës. Mandati i kësaj zyre është monitorimi, mbrojtja dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave që kanë punë me DHSK-në ose ZPS-në. Përmbledhtazi, funksioni i Avokatit të Popullit është të vlerësojë nëse DHSK-ja dhe ZPS-ja u përmbahen standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Si pjesë e funksionit të vet, Zyra e Avokatit të Popullit duhet të ketë një procedurë solide ankesash përmes së cilës individët mund të ngrenë pretendime për shkelje të të drejtave të tyre themelore nga ana e DHSK-së ose ZPS-së. Pas marrjen së ankesës, Avokati i Popullit e shqyrton atë dhe, kur është e përshtatshme, kryen hetime në lidhje me shkeljet e pretenduara dhe në vijim nxjerr një raport përfundimtar me

rekomandime për Kryetaren ose Prokurorin e Specializuar. Po kështu, në kuadër të funksionit të vet monitorues, Avokati i Popullit mund t'u ofrojë DHSK-së dhe ZPS-së këshilla në vazhdimësi që synojnë garantimin e përputhshmërisë së plotë me standardet më të larta të të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit nuk ndërhyr në proceset gjyqësore para Dhomave të Specializuara, përveçse në raste vonesash të paarsyeshme. Është me rëndësi të theksohet se Avokati i Popullit është gjithmonë i pavarur dhe i paanshëm.

Në vitin 2017, këshilltari juridik i Zyrës së Avokatit të Popullit filloi punën për ngritjen e kapaciteteve për shqyrtimin e ankesave, monitorimin e përputhshmërisë, dhe kryerjen e veprimtarive për komunikim dhe ndërgjegjësim në përgatitje për emërimin e Avokatit të Popullit në vitin 2018.

5 Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore

Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore përbëhet nga Njësia për Administrimin e Gjykatës, Njësia e Shërbimeve Gjuhësore, Zyra e Mbrojtjes, Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, dhe Njësia e Paraburgimit.

5.1 Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ)

Në emër të Administratorit, Njësia për Administrimin e Gjykatës ('NJAGJ') mban në ruajtje të gjithë dokumentacionin gjyqësor dhe është përgjegjëse për të gjitha parashtrimet dhe ruajtjen e integritetit të provave fizike. NJAGJ-ja kryen shërbimet e nevojshme për seancat gjyqësore, duke siguruar që sallat e gjyqit të kenë pajisjet dhe personelin e duhur; administron dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e lëndëve, dhe këshillon Administratoren dhe Dhomat për çështje procedurale. NJAGJ-ja bën kërkesë për shërbimet e përkthimit për procedurat gjyqësore dhe merr në dorëzim dhe u shpërndan palëve dhe pjesëmarrësve të gjithë dokumentacionin dhe provat përkatëse.

Legal Workflow

DHSK-ja ka krijuar mjete për marrjen, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen elektronike të dokumentacionit të çështjeve. DHSK-ja ka blerë një sistem elektronik për administrimin e dokumentacionit gjyqësor, të cilin e ka konfiguruar sipas nevojave të DHSK-së duke iu përmbajtur praktikave më të mira për administrimin e të dhënave në procese gjyqësore të ndërlikuara. Ky sistem, *Legal Workflow*, është i përdorshëm në të gjitha aspektet e procedurave të DHSK-së dhe u mundëson gjykatësve, palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë që të shohin, analizojnë, nxjerrin dhe paraqesin të gjitha provat brenda një sistemi të integruar.

NJAGJ-ja ka blerë një sistem elektronik për administrimin e dokumentacionit gjyqësor (*Legal Workflow*) për marrjen në dorëzim dhe shpërndarjen e parashtrimeve, të cilin tashmë e ka konfiguruar dhe vënë në punë me sukses. Gjithashtu janë përpiluar dhe miratuar udhëzime të përkohshme për dorëzimin elektronik të parashtrimeve.

NJAGJ-ja mundëson incizimin zanor dhe filmimin e procedurave gjyqësore në sallë të gjyqit. Në vitin 2017 u mbajtën dy seanca para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK), ku u përgatitën transkripte dhe incizime zanore dhe filmime në të tri gjuhët zyrtare të DHSK-së: shqip, serbisht, dhe anglisht.

5.2 Njësia e Shërbimeve Gjuhësore (NJSHGJ)

NJSHGJ-ja ofron shërbime gjuhësore në të tri gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Shërbimet e kësaj njësie vënë në jetë angazhimin e vendosur të DHSK-së ndaj marrëdhënieve me publikun dhe veprimtarive të programit për komunikim dhe ndërgjegjësim në rajon, si dhe ndaj parimeve të transparencës dhe qasshmërisë.

NJSHGJ-ja përbëhet, ndër të tjerë, nga përkthyes me shkrim, redaktorë, përkthyes me gojë për proceset gjyqësore, si dhe asistentë të gjuhës dhe të terminologjisë. Së bashku, ata ofrojnë shërbime gjuhësore për mbledhjet, takimet dhe seancat gjyqësore, në pajtim të plotë me standardet më të larta ndërkombëtare. NJSHGJ-ja ka ofruar ekspertizën e vet edhe për sa u përket kërkesave shumë specifike teknike për pajisjet e përkthimit

me gojë në sallën e gjyqit, ka formuluar praktika dhe udhëzime të rëndësishme të brendshme dhe ka blerë teknologji për automatizimin e proceseve të marrjes dhe dorëzimit të përkthimeve.

NJSHGJ-ja ka bërë me mijëra faqe përkthime, ndër të cilat përkthime të dokumenteve ligjore, si: Rregullorja e Procedurës dhe e Provave, Rregullorja e Punës dhe aktvendimet e DHSGJK-së, dokumente të tjera ligjore, Direktiva për Mbrojtësit, si dhe punë në ndihmë të ZPS-së. Së fundi, një pjesë e rëndësishme e punës së NJSHGJ-së është përkthimi i materialeve për faqen e DHSK-së në Internet, duke e bërë atë lehtësisht të përdorshme në të tri gjuhët zyrtare.

5.3 Zyra e Mbrojtjes (ZM)

Një mbrojtje e fortë është thelbësore për garantimin e një gjykimi të drejtë. Zyra e Mbrojtjes garanton të drejtat e të dyshuarve dhe të akuzuarve përmes hartimit dhe administrimit të një liste mbrojtësish që plotësojnë kriteret profesionale, të aftë dhe me përvojë, që përmbushin standardet e integritetit dhe ndershmërisë së nevojshme për procese gjyqësore të drejta. Gjithashtu, ZM-ja administron një sistem të ndihmës juridike për t'u mundësuar të dyshuarve dhe të akuzuarve të varfër ose pjesërisht të varfër përfaqësim shumë të kualifikuar para DHSK-së, si dhe ofron mbështetje administrative për të gjithë mbrojtësit.

Është e rëndësishme të theksohet se, si pjesë e Zyrës Administrative, Zyra e Mbrojtjes ka rol asnjës në interes të drejtësisë dhe nuk merr pjesë në paraqitjen dhe argumentimin e fakteve të çështjeve në gjykime. Mandati i Zyrës së Mbrojtjes është të sigurojë drejtësi për të gjithë të dyshuarit dhe të akuzuarit para DHSK-së, duke garantuar përmbushjen e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut gjatë kryerjes së funksioneve të veta.

Gjatë periudhës që mbulon ky raport, Zyra e Mbrojtjes ka bashkëpunuar nga afër me Zyrën për Pjesëmarrjen e Viktimave dhe këshilltaren juridike në Kabinetin e Administtores, për hartimin e **Direktivës për Mbrojtësit**, të cilën Administratorja e lëshoi më 6 nëntor 2017, me miratimin e Kryetares pas këshillimeve me gjykatësit.

Pas miratimit të Direktivës, DHSK-ja shpalli një ftesë pa afat për paraqitjen e kërkesave. Brenda dy muajve të parë të ftesës, më shumë se 70 avokatë bënë kërkesë për t'u pranuar në Listë dhe Zyra e Mbrojtjes vazhdon të marrë dhe shqyrtojë kërkesa të reja. Gjithashtu, Zyra e Mbrojtjes ka zhvilluar veprimtari për komunikim dhe ndërgjegjësim në Kosovë, për të nxitur aplikimet nga avokatë që i përmbushin kushtet. Koordinatorin e Zyrës së Mbrojtjes është takuar me përfaqësues të Odës së Avokatëve të Kosovës, përfaqësues të Shoqatës së Avokatëve Mbrojtës të Tribunalëve Penalë Ndërkombëtarë (ADC-ICT), si dhe me pjesëmarrësit në 'Takimin Ndërkombëtar të Mbrojtjes' në Nuremberg, Gjermani.

Direktiva për Mbrojtësit

Direktiva rregullon kriteret e pranueshmërisë dhe procedurat e aplikimit për pranim në Listën e Mbrojtësve, detyrimet në vijimësi të mbrojtësve të përfshirë në Listë, si dhe modalitetet e vetëtërheqjes ose përjashtimit nga Lista.

Direktiva zbatohet si për mbrojtësit e angazhuar privatisht, ashtu edhe për ata që paguhen përmes ndihmës juridike. Vetëm mbrojtësit që plotësojnë kriteret e pranimit në Listë kanë të drejtë të përfaqësojnë të dyshuarit dhe të akuzuarit para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në qendër të përpjekjeve të Zyrës së Mbrojtjes është edhe krijimi i një sistemi të ndihmës juridike që u përmbahet standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë dhe kriterëve për administrim financiar

të mirë. Zyra e Mbrojtjes është duke bashkëpunuar me Zyrën për Pjesëmarrjen e Viktimave dhe Kabinetin e Administratores për hartimin e Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit.

5.4 Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV)

Ligji parasheh pjesëmarrjen e viktimave në procedura penale para Dhomave të Specializuara. ZPV-ja është përgjegjëse për administrimin e sistemit të pjesëmarrjes së tyre dhe për ndihmë viktimave që marrin pjesë në proces. Qëllimi i krijimit dhe punës së ZPV-së që në fazë të hershme, është mundësimi i pjesëmarrjes aktive të viktimave në gjykimet e ardhshme. Viktimat marrin pjesë në procedura në grupe që formohen nga një panel gjykatësish sipas çështjeve përkatëse gjyqësore dhe i ushtrojnë të drejtat e tyre përmes një mbrojtësi të viktimave që caktohet për secilin grup. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave administron sistemin për pjesëmarrjen e viktimave, përfshirë edhe Listën e Mbrojtësve të Viktimave që kanë të drejtë të dalin para DHSK-së, si dhe pagesën për përfaqësim ligjor.

ZPV-ja ka punuar për hartimin e rregulloreve të administrimit të brendshëm në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e tjera të Zyrës Administrative.

Gjithashtu, kjo zyrë ka përgatitur materiale udhëzuese dhe materiale komunikimi dhe ndërgjegjësimi për viktimat e mundshme. Komunikim dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve të prekura në Kosovë ka qenë një përparësi kryesore në punën e ZPV-së, mirëpo ZPV-ja është përqendruar edhe në veprimtari me komunitetin e juristëve. Synimi i këtyre takimeve është rritja e ndërgjegjësimit, si dhe shpjegimi i procesit dhe kushteve të aplikimit.



Shefja e ZPV-së duke folur në një takim me shoqërinë civile në Mitrovicë - 2018

Kush përkufizohet viktimë në procedurat para DHSK-së?

“Personi fizik që ka pësuar dëm fizik, material ose mendor si rezultat i drejtpërdrejtë i veprave penale të pretenduara në një aktakuzë të konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake” (Rregulla 2 e Rregullores së Procedurës dhe Provable).

Pas konfirmimit të aktakuzës, viktimat mund të bëjnë kërkesë dhe t'i jepet statusi procedural i viktimës pjesëmarrëse në procedurat para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Mbrojtësit e Viktimave

Mbrojtësit e Viktimave duhet të provojnë se kanë pesë vjet përvojë përkatëse pune në çështje penale lidhur me viktimat, brenda përvojës së punës 7 deri 10 vjet në procedura penale që është kriter për të gjithë avokatët. Kjo do të garantojë që viktimat të përfaqësohen nga mbrojtës të kualifikuar të cilët janë në gjendje të përballojnë vështirësitë që lidhen me përfaqësimin e grupeve të personave.

5.5 Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD)

Në emër të Administratores, ZMMD-ja është përgjegjëse për garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së dëshmitarëve, viktimave që marrin pjesë në procedura dhe, sipas rrethanave, të personave të tjerë që rrezikohen për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët.

ZMMD-ja do të ndërmarrë një proces të gjerë vlerësimi të çdo personi që mund të përfshihet në kompetencat e veta, për të siguruar trajtimin e duhur të çdo rreziku të mundshëm dhe rekomandimin e masave më të mira të mundshme.

ZMMD-ja garanton sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve, viktimave që marrin pjesë në procedura dhe personave të tjerë që mendohet se mund të rrezikohen për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët.

Gjatë zbatimit të programeve mbrojtëse, ZMMD-ja do të drejtojë masat për mbështetjen dhe sigurinë e të gjithë dëshmitarëve dhe të personave të tjerë, përfshirë edhe masat e urdhëruara nga panelet e DHSK-së. ZMMD-ja gjithashtu mund të rekomandojë miratimin e masave mbrojtëse brenda gjykatës.

Gjithashtu, ZMMD-ja do të jetë përgjegjëse për vlerësimin e nevojave të dëshmitarëve për ndihmë mjekësore dhe psikologjike dhe/ose për këshillim psikologjik përpara, gjatë dhe pas procedurave gjyqësore. ZMMD-ja do t'u ofrojë mbështetje

specifike, të përshtatur për nevojat e tyre, dëshmitarëve të traumatizuar, të cenueshëm, ose që mund të kenë nevoja të veçanta familjare, gjinore, kulturore ose mjekësore, përfshirë këtu edhe dëshmitarët që mund të kenë qenë viktimë të dhunës seksuale dhe gjinore.

Përnjë mbështetje sa më të madhe të dëshmitarëve, ZMMD-ja është e gatshme të administrojë të gjitha masat logjistike dhe operative, në mënyrë që dëshmitarët, apo persona të tjerë, të marrin pjesë dhe të dëshmojnë. Për shembull, janë krijuar kapacitete të brendshme për të organizuar udhëtimin dhe qëndrimin e dëshmitarëve, shoqëruesit e tyre, si dhe masat e nevojshme për personat mbështetës të dëshmitarëve.

5.6 Njësia e Paraburgimit (NJP)

NJP-ja është përgjegjëse për drejtimin dhe administrimin e objekteve të paraburgimit të DHSK-së. Mandati i NJP-së është të garantojë që personat e paraburgosur nën autoritetin e Dhomave të Specializuara të Kosovës të mbahen në pajtim me standardet ndërkombëtare, praktikat më të mira të paraburgimit, dhe ligjet në fuqi. Gjithashtu, roli i NJP-së është që të këshillojë Administratoren për çështje që kanë të bëjnë me paraburgimin, t'u përgjigjet kërkesave për informacion me shpejtësi dhe saktësi dhe t'u mundësojë të paraburgosurve të marrin pjesë në proces.

Ekipi drejtues i NJP-së i përbërë nga punonjës të Dhomave të Specializuara të Kosovës, do të përzgjedhë nga Shërbimi i Burgjeve të Holandës punonjësit që do të punësohen për funksionimin e Njesisë së Paraburgimit ku do të mbahen të dyshuarit, të akuzuarit dhe të paraburgosurit e tjerë nën autoritetin e DHSK-së. NJP-ja do të bashkëpunojë ngushtësisht me Shërbimin e Burgjeve të Holandës për të garantuar që mbajtja e personave

në Njësinë e Paraburgimit të bëhet në pajtim me protokollet e miratuara. NJP-ja do të sigurojë mjediset e punës për drejtuesit, administratën dhe përkthyesit në Njësinë e Paraburgimit.

Gjatë periudhës së raportimit, NJP-ja së bashku me KA-në, kanë punuar për hartimin e Rregullores së Paraburgimit dhe udhëzuesve të tjerë të brendshëm në pajtim me Rregullat Standarde Bazë të

Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullorja *Nelson Mandela*) dhe Rregulloren Evropiane për Burgjet. Është me rëndësi të theksohet që Rregullorja e Procedurës dhe Provave parasheh inspektimin dhe monitorimin e objekteve të paraburgimit nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, dhe i lejon Avokatit të Popullit të inspektojë mjediset e paraburgimit në çfarëdo kohe dhe pa paralajmërim.

6 Seksioni i Administratës

Seksioni i Administratës kryen të gjitha shërbimet mbështetëse administrative dhe teknike. Seksioni përbëhet nga gjashtë njësi: Burimet Njerëzore, Teknologjia e Informacionit, Administrimi i Objekteve dhe Shërbimet e Përgjithshme, Siguria, Financat dhe Buxheti, dhe Prokurimi. Shefi i seksionit i raporton Administratores dhe mbikëqyr punën e përditshme të njërive. Gjatë gjithë periudhës që mbulon ky raport, seksioni u ka bërë ballë sfidave që ndeshen zakonisht gjatë ndërtimit të një institucioni, dhe po realizon të gjitha shërbimet mbështetëse për sigurimin e kapaciteteve të plota operative.

6.1 Njësia e Burimeve Njerëzore (NJBNI)

NJBNI-ja ofron ndihmë, këshilla dhe shërbime për të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe të ZPS-së lidhur me çështje të burimeve njerëzore. Njësia drejton procesin e rekrutimit, sistemin e pagave dhe përfitimeve, mirëqenien dhe trajnimet e punonjësve, si dhe procesin e vlerësimit të punës. Një ndër detyrat kyçe është promovimi i një atmosfere mbështetëse për punën, ku përfshihen dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimet për

përballimin e stresit, si dhe ofrimi i shërbimeve këshilluese psikologjike sipas nevojës.

Pas miratimit të Rregullores së Personelit dhe Kodit Etik nga Administratorja, NJBNI-ja në bashkëpunim me KA-në hartoi dhe vuri në zbatim direktiva administrative të shumta, përfshirë procedurat për përzgjedhjen e personelit, vlerësimin e punës, praktikantët dhe pushimet që janë të nevojshme për funksionimin efektiv të DHSK-së. Parimi i mishëruar në të gjitha rregulloret është se procedurat për përzgjedhjen e personelit janë të drejta, transparente dhe jodiskriminuese dhe respektojnë konfidencialitetin e mbrojtjen e të dhënave personale.


Përzgjedhja dhe punësimi i punonjësve të rinj për DHSK-në dhe ZPS-në ka qenë përparësi gjatë periudhës së raportimit. Kanë dalë pesë Ftesa për Aplikime (FpA) në të cilat janë shpallur vendet e lira të punës në të dy institucionet. Administrimi i duhur i FpA-ve ka rezultuar në rritjen e të dy institucioneve dhe rritjen e numrit të personelit nga 53 në vitin 2016, në 148 në vitin 2017. Po kështu, NJBNI-ja ka shpallur edhe dy FpA për praktikantë, me anë të të cilave është bërë i

mundur punësimi i 27 praktikantëve. Qëllimi i rekrutimit të punonjësve është plotësimi i nevojave operative dhe gjatë procesit të rekrutimit i kushtohet vëmendje përbërjes gjinore dhe shpërndarjes gjeografike.


Punësimi në DHSK i punonjësve të emëruar nëpërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuuese nxitet në mënyrë aktive. Gjatë periudhës që mbulon ky raport, numri i punonjësve të emëruar nëpërmjet këtyre shteteve është luhatur nga 9 deri në 14 dhe më 31 dhjetor

2017 ishin gjithsej 11 punonjës të emëruar nëpërmjet katër shteteve anëtare të BE-së (Gjermania, Irlanda, Holanda, dhe Britania e Madhe) dhe dy shteteve të treta kontribuuese (Zvicra dhe SHBA). Në gjysmën e parë të vitit 2018 priten edhe katër emërimë të tjera nëpërmjet tri shteteve të tjera anëtare të BE-së (Bullgaria, Hungaria dhe Malta). DHSK-ja dhe ZPS-ja vazhdojnë të jenë plotësisht të angazhuara në rrafshin diplomatik për t'i nxitur shtetet të dërgojnë personel të kualifikuar për vendet e shpallura të punës.


Numri i personelit të DHSK-së dhe ZPS-së sipas shteteve



Përbërja gjinore e personelit në DHSK dhe ZPS



Numri i gjithsejtë i personelit të DHSK-së dhe ZPS-së



6.2 Njësia e Teknologjisë së Informacionit (NJTI)

NJTI-ja ofron teknologji informative (TI) të sigurt dhe shërbime audiovizuale në mbështetje të punës së Dhomave të Specializuara të Kosovës. Njësia ka ngritur nga themelet infrastrukturën qendrore të TI-së dhe sistemet e programeve kompjuterike të DHSK-së.

Ndër arritjet kryesore përfshihen përrurimi i faqeve të internetit dhe intranetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe instalimi i sistemit "VBlock", që është bazë për të gjitha aplikacionet e DHSK-së. Ky sistem ka eliminuar nevojën për të bërë konfigurimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin individual të një numri të madh serverësh dhe pajisjesh të rrjetit.

NJTI-ja ka vënë në funksionim në të gjithë institucionin një rrjet të sigurt dhe modern të TI-së – një rrjet i zgjerueshëm dhe i qëndrueshëm në mbështetje të të gjitha proceseve të Dhomave të Specializuara të Kosovës, përfshirë edhe procedurat gjyqësore.

Janë integruar dhe testuar plotësisht instrumente të fuqishme të sigurisë së rrjetit. NJTI-ja ka vënë në funksionim gjithashtu edhe aplikacione për përkthim, transkriptim dhe përdorim nga distanca, për t'u mundësuar gjykatësve dhe punonjësve të tjerë të punojnë të sigurt nga distanca. Në bashkërendim me NJAGJ-në, është vënë në punë edhe instrumenti për sistemin elektronik të dokumentacionit gjyqësor, 'Legal Workflow'.

NJTI-ja, në bashkërendim me shtetin pritës, ka marrë pjesë në projektimin dhe vënien në funksionim të infrastrukturës së TI-së dhe pajisjeve audiovizuale të sallave të gjyqit të DHSK-së për të ardhmen. Mjediset e zyrave të përkohshme janë pajisur me pajisje audiovizuale, çka mundësoi me sukses përrurimin e parë të gjykatësve, seancat e para plenare, vizita nga personalitete të shquara dhe veprimtari me shtypin.

6.3 Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP)

NJAOSHP-ja ka bërë të mundur kalimin e personelit nga Brukseli në ndërtesën e përkohshme dhe ka përgatitur mjediset aktuale të punës për personelin.

NJAOSHP-ja ka krijuar hapësira funksionale pune për DHSK-në dhe ZPS-në, duke ndihmuar kështu zhvillimin e të dy institucioneve. Ajo është përgjegjëse për administrimin e objektit të përkohshëm dhe ndihmon të gjithë punonjësit e rinj për çështje protokollare në shtetin pritës.

NJAOSHP-ja administron mirëmbajtjen e godinës, caktimin e hapësirave të zyrave, shërbimin postar, pastrimin dhe administrimin e mbeturinave, udhëtimet, transportin dhe logjistikën. Gjithashtu, kjo njësi merret me protokollin për takime diplomatike dhe vizita të personaliteteve të shquara,

si dhe bashkërendimin e veprimtarive. NJAOSHP-ja bashkërendon punën midis DHSK-së dhe ZPS-së për t'i dhënë shtetit pritës të gjitha hollësitë funksionale për selinë e re, me qëllim që në objektin e ri të kryhen procedura gjyqësore të sigurta.

6.4 Njësia për Siguri (NJS)

NJS-ja ofron siguri me një spektër të gjerë për të gjitha veprimet dhe veprimtaritë e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

NJS-ja ka hedhur themelet e ndërgjegjësimit për sigurinë në të gjithë DHSK-në, për uljen e rrezikueshmërisë. Kjo njësi përdor programet ndërvepruese të trajnimit për çështje të sigurisë të Shërbimit të Jashtëm të BE-së (BASE dhe SAFE), për të rritur ndërgjegjësimin e punonjësve dhe për të mundësuar marrjen e vendimeve nga individët për minimizimin e rreziqeve personale, operative dhe të reputacionit.

Qëllimi parësor i NJS-së ka qenë të krijojë, ofrojë, dhe ruajë një kulturë efektive sigurie në radhët e punonjësve dhe të zbusë rreziqet ndaj sigurisë së personelit, veprimtarive dhe objekteve të DHSK-së.

Gjithashtu, NJS-ja bashkëpunon ngushtë me autoritetet e shtetit pritës dhe monitoron vazhdimisht rreziqet që mund t'i kanosen DHSK-së, për të garantuar një reagim efikas në aspektin e sigurisë. NJS-ja ka krijuar një strukturë efektive për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me misionet dhe veprimtari të tjera të lidhura me procedurat gjyqësore.

6.5 Njësia e Financave dhe Buxhetit (NJFB)

NJFB-ja ndihmon Administratoren në lidhje me administrimin financiar dhe zbatimin e Marrëveshjes për Subvencionim, në pajtim me rregullat dhe rregulloret financiare të brendshme dhe ato të BE-së. Nën drejtimin e Administratores, NJFB-ja ka përgjegjësinë të bashkërendojë planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit vjetor. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për kryerjen e pagesave dhe regjistrimin e shpenzimeve përmes forcimit të kontrollit të brendshëm financiar dhe ofrimit të ndihmës dhe trajnimeve brenda institucionit.

Me Vendim të Këshillit të BE-së (CFSP) 2016/947, shtetet anëtare të BE-së miratuan një buxhet prej 29.100.000 eurosh për periudhën nga 15 qershor 2016 deri më 14 qershor 2017, ndërsa me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2017/973 u miratua një buxhet prej 41.314.000 Euro për periudhën nga 15 qershor 2017 deri më 14 qershor 2018.

Përveç fondeve që merr nga BE-ja, DHSK-ja ka marrë fonde edhe nga qeveria norvegjeze në shumën prej 80 milionë koronash norvegjeze për të mbështetur zhvendosjen e procedurave në mjediset e reja në Hagë. Në dhjetor të vitit 2017, qeveria zvicerane konfirmoi financimin prej 181.200 eurosh për veprimtarinë e programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së në vitin 2018 dhe 2019.

NJFB-ja vazhdon të mbështesë një administratë efikase dhe të pavarur, përmes krijimit dhe zbatimit të një numri sistemesh, rregullash dhe procedurash që garantojnë administrim financiar të mirë të fondeve. Në pajtim me Marrëveshjen për Subvencionim, një firmë e jashtme auditimi kryen rregullisht verifikime të pavarura të shpenzimeve në llogaritë financiare dhe ajo nuk ka bërë asnjë konstatim faktik. Në fund të çdo periudhe raportuese, Instrumentit të Politikës të Jashtme (IPJ) të Komisionit Evropian i dorëzohen pasqyrat e llogarive të përfunduara dhe raportet e verifikimit të shpenzimeve.

NJFB-ja e ndihmon Administratoren duke siguruar përdorim të rregullt dhe administrim financiar të mirë të fondeve që i janë livruar DHSK-së. Llogaritë financiare i nënshtrohen rregullisht verifikimit nga një firmë e jashtme auditimi. Që nga krijimi, verifikimet e shpenzimeve nuk kanë konstatuar asnjë shkelje.

6.6 Njësia e Prokurimit (NJP)

Njësia e prokurimit është përgjegjëse për të gjitha blerjet dhe kontraktimet e furnizimeve, shërbimeve dhe punimeve. Kontratat jepen mbi bazën e parimeve të transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

Përveç menaxhimit të nevojave të prokurimit në shërbim të veprimtarive për ngritjen e DHSK-së dhe punën e saj në vijimësi, Njësia e Prokurimit siguron gjithashtu që DHSK-ja t'u përmbahet rregullave të BE-së (EU PRAG) për veprimet prokuroese. Në bashkëpunim të ngushtë me këshilltaren juridike të KA-së dhe Komisionin Evropian, NJP-ja ka vënë në zbatim edhe një procedurë të veçantë për marrjen në shërbim të juristëve për nevoja të caktuara të DHSK-së. Gjithashtu, Njësia e Prokurimit bën administrimin dhe monitorimin e kontratave dhe kryen hulumtime të tregut.

Gjatë periudhës së raportimit, janë filluar 173 procedura prokurimi dhe janë përfunduar 90 kontrata për shërbime dhe furnizime, me vlerë që shkon nga 2500 euro deri në 1 milion euro.

**ZYRA E
PROKURORIT TË
SPECIALIZUAR**

Parathënie

Më 2011, me mbështetjen e njëzëshme të Komitetit Politik dhe për Sigurinë të Këshillit Evropian dhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, në Bruksel u themelua Task Forca Hetimore Speciale (TFHS) si pjesë përbërëse e Misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë për hetimin e pretendimeve të Raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të 7 janarit 2011 titulluar *Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë*.

Duke mësuar prej përvojave të institucioneve gjyqësore dhe të prokurorisë që veprojnë në Kosovë, TFHS-ja krijoi praktika për garantimin e konfidencialitetit të të dhënave dhe veprimtarisë së vet si dhe për privatësinë e individëve të përfshirë në hetime si dhe u kushtoi rëndësi të posaçme sigurisë së dëshmitarëve dhe ruajtjes së integritetit të hetimeve. Këto praktika i ka trashëguar edhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS). Me vijimin e punës së mëtejshme ne do të ofrojmë shpjegime brenda mundësive dhe në përputhje me detyrimet tona ligjore, profesionale dhe etike se çfarë po bëjmë dhe në çfarë mënyre punojmë.

Që të arrihet drejtësi, duhet që kjo drejtësi edhe të shihet. Që prej krijimit, krahas mbledhjes së provave, angazhimit të viktimave dhe grupeve të viktimave dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve, TFHS-ja e nxiti BE-në që të mbështeste krijimin e një gjykate jashtë Kosovës për kryerjen e procedimeve penale të sigurta, të pavarura, të paanshme dhe të drejta për trajtimin e rezultateve të hetimeve të veta. Kjo ishte një domosdoshmëri për t'u dhënë besim viktimave, dëshmitarëve dhe atyre që mund të jenë të rrezikuar për shkak të

bashkëpunimit në hetime, si dhe për të garantuar që institucioni të jetë i mbrojtur kundrejt ndikimeve dhe ndërhyrjeve, të jetë i pavarur dhe i besueshëm.

Ne kishim bindjen se duke vepruar në këtë mënyrë do të ishim në gjendje të përmbushnim detyrimet tona në bazë të Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut, për mundësimin e garancive mbrojtëse të mjaftueshme për viktimat, dëshmitarët dhe persona të tjerë të rrezikuar për shkak të informatave të dhëna TFHS-së, ose bashkëpunimit me të. Gjatë tërë kohës, ky ka qenë një faktor me rëndësi madhore për TFHS-në dhe ZPS-në. Rregulla 30 e Rregullores së Procedurës dhe Provave ia ngarkon këtë detyrim Prokurorit të Specializuar.

Gurthemeli tjetër mbi të cilin bazohet sukcesi është angazhimi i plotë i shteteve dhe organizatave, si edhe individëve të cilët ndihmojnë në hetime dhe nëse është e nevojshme do të dëshmojnë në gjyqet e ardhshme. Ndihma e vazhdueshme e autoriteteve në Beograd dhe Prishtinë, si dhe nga Bashkimi Evropian dhe më gjerë nga bashkësia ndërkombëtare, luan rol thelbësor për hetimet e kjo ndihmë përfshin dhënien e dokumenteve të kohës, lejimin për kontaktimin e ish-zyrtarëve, kryerjen e hetimeve jashtë Kosovës dhe ofrimin e mundësive të ndryshme për sigurinë e dëshmitarëve.

Që prej themelimit më 1 shtator 2016, Zyrës së Prokurorit të Specializuar i është mundësuar funksionimi nëpërmjet dhënies së burimeve dhe mjeteve, përcaktimit të kornizës ligjore dhe mbështetjes administrative dhe logjistike. Nga ana e tij, Prokurori i Specializuar ka për detyrë

kryerjen e hetimeve efikase dhe të shpejta duke punuar në mënyrë të zellshme, të ndershme dhe dinjitoze dhe ngritjen pa vonesë të aktakuzave.

Periodha që hetohet ndërthen një kohë të angazhimit intensiv të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë ku përfshihen përpjekjet për përfundimin e konfliktit që shkaktoi vuajtje të mëdha për të gjithë njerëzit dhe për stabilizimin e situatës pas konfliktit. Mandati i Zyrës së Prokurorit të Specializuar përqendrohet në vepra penale që kanë lidhje me pretendime për kryerjen e krimeve ndërkufitare dhe ndërkombëtare gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë për të cilat mbajnë përgjegjësi individë dhe jo grupe apo forca anëtarë apo përfaqësues të cilëve mund të kenë qenë individët në fjalë.

Viti i ardhshëm do të jetë tejet i rëndësishëm për Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS), ndërkohë që hetimet tonë shkojnë më tej. Që me fillimin e punës prej Task Forcës Hetimore Speciale në vitin 2011 vetëm me dy dosje me materiale, ne kemi mbledhur diku rreth 70,000 dokumente që numërojnë afërsisht 700,000 faqe. Puna jonë në muajt e kaluar është përqendruar në shqyrtimin e këtyre provave për të mundësuar që të jemi të gatshëm për çfarëdo procedure gjyqësore eventuale në pajtim me Rregulloren e Procedurave dhe të Provave dhe së bashku me rezultatet e hetimeve ekzistuese kjo punë do t'i mundësojë Prokurorit të Specializuar të vendosë nëse do të ngrëjë akuza. Vendimet për ngritjen e akuzave, personat të cilët do të akuzohen dhe për çfarë akuzash, janë kompetencë e Prokurorit të Specializuar. Vendime të tilla do të merren me kujdesin dhe vëmendjen më të madhe pas një procesi reflektues dhe rrënjësor.

Udhërrëfyes për Prokurorin e Specializuar janë vetëm ligji dhe faktet, asgjë tjetër. Prokurori i Specializuar do t'i shqyrtojë ngjarjet brenda mandatit të vet, pa vonesë, tërësisht dhe paanësisht dhe do të kryejë hetimin për zbardhjen e së vërtetës mbi këto ngjarje.

Ne jemi të përkushtuar për arritjen e një rezultati legjitim që do të pranohet si legjitim prej bashkësisë ndërkombëtare dhe prej njerëzve që kanë vuajtur pasojat e konfliktit dhe për nxjerrjen para përgjegjësisë, të individëve fajtorë për kryerjen e veprave penale brenda mandatit për veprimet e tyre, pa frikë dhe anësi.

Kwai Hong Ip

*Ushtrues i detyrës së Prokurorit të Specializuar
prill 2018*

Zhvillimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) u themelua më 1 shtator 2016 në Hagë si institucion kosovar i ndërkombëtarizuar dhe i zhvendosur, institucion që trashëgoi punonjësit dhe mandatin e Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS). Që nga ai moment, ZPS-ja ka vazhduar hetimet e filluara nga TFHS-ja me qëllim marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me akuzat që kanë të bëjnë me krime të caktuara të kryera gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në Kosovë.

Mandati i ZPS-së buron nga Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015, në bazë të të cilit u krijuan Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Dhomat e Specializuara. Ligji e autorizon ZPS-në që të hetojë dhe ndjekë penalisht krimet e kryera në lidhje me veprimet e identifikuara në Raportin e Këshillit të Evropës të janarit 2011, *Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë*. Ky dokument zakonisht njihet si “Raporti Marti” sipas Dik Martit (Dick Marty), ish-prokuror dhe senator zviceran dhe anëtar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës i cili kryesoi hetimet që rezultuan në këtë raport.

ZPS-ja është duke hetuar krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare, që do të thotë, kryesisht krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, sikurse përkufizohen në të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe siç janë përcaktuar në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Krime brenda juridiksionit të ZPS-së

Raporti i Këshillit të Evropës

Pas botimit të kujtimeve të titulluara *Madame Prosecutor (Zonja Prokurore)*, të ish-Kryeprokurores së TPNJ-së (Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë), Karla Del Ponte (Carla Del Ponte), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës caktoi senatorin zviceran, Dik Marti për hetimin e pretendimeve të paraqitura në të. Senator Marti kishte udhëhequr më herët hetimet e Këshillit të Evropës në lidhje me pretendimet për burgjet e paligjshme të CIA-s në Evropë, duke publikuar dy raporte me konkluzionet e veta në qershor 2006 dhe qershor 2007.

Senator Marti përpiloi një raport në lidhje me pretendimet e Del Pontes të titulluar *Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë*, të cilin Këshilli i Evropës e miratoi në janar 2011. Në këtë raport që zakonisht përmendet si “Raporti Marti”, Marti erdhi në përfundim se kishte tregues të besueshëm për shumë nga pretendimet në librin e Del Pontes, duke përfshirë dhe ato në lidhje me marrjen e organeve. Raporti Marti gjithashtu ngarkoi me përgjegjësi komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shumë nga të cilët më pas morën poste të larta në Kosovë



Senator Dik Marti – © Këshilli I Evropës

janë të gjitha krimet që janë kryer ose filluar në Kosovë në periudhën trevjeçare midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000. Personeli i cili përfshin prokurorë, hetues, analistë, ekspertë të sigurisë, ekspertë të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe personel ndihmës, është i gjithi ndërkombëtar. Që nga shndërrimi në ZPS, personeli 35-anëtarësh i TFHS-së është rritur gradualisht, afërsisht në 60 punonjës që vijnë nga më shumë se 20 shtete.

Ndër të tjera, ZPS-ja ka kompetencë që të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të të dyshuarve, viktimave dhe dëshmitarëve, të mbledhë dhe ekzaminojë të dhëna dhe prova, dhe të marrë vendime në lidhje me fillimin dhe vazhdimin ose përfundimin e procedurave penale. Zyra e Prokurorit të Specializuar synon të nxjerrë para përgjegjësisë individët për krimet që mbulohen nga mandati i vet.

Ndihma e autoriteteve në Beograd dhe Prishtinë, si dhe nga Bashkimi Evropian dhe më gjerë nga bashkësia ndërkombëtare, luan rol thelbësor për hetimet. Zyra e Prokurorit të Specializuar ka kërkuar dhe vazhdon të kërkojë ndihmë nga çdo person dhe institucion, vendor apo ndërkombëtar, për përparimin e hetimeve dhe për të garantuar kryerjen e tyre në mënyrë objektive, profesionale, të paanshme, të plotë dhe mirë. Pavarësisht nga orvatjet për shfuqizimin apo ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, ZPS-ja mbetet e përqendruar në përmbushjen e përgjegjësisë të veta.

David Shvendiman (Schwendiman), ish-prokuror federal i SHBA-së dhe më herët edhe zëvendës-kryeprokuror dhe shef i Departamentit Special për krime lufte në Bosnjë-Hercegovinë ishte i pari që u emërua Prokuror i Specializuar më 1 shtator 2016, kur TFHS-ja u shndërrua në Zyrën e Prokurorit të

Specializuar (ZPS). Para këtij emërimi ai kishte qenë Kryeprokuror i TFHS-së nga maji 2015.

Z. Shvendiman vizitoi Beogradin dhe Prishtinën në nëntor 2016. Gjatë vizitës, ndër zyrtarët të cilët takoi ishin edhe Kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Isa Mustafa, dhe Kryeministri i atëhershëm i Serbisë, Aleksandar Vučić (Aleksandar Vučić).

Gjatë vitit të kaluar ZPS-ja ka shqyrtuar me vëmendje provat e mbledhura që nga koha kur TFHS-ja filloi punën në vitin 2011, ku përfshihen rreth 70.000 dokumente, që numërojnë thuhetse 700.000 faqe material, Prokurori i Specializuar ka punuar drejt një vendimi për ndjekje penale, por ai ngre aktakuzë vetëm nëse bindet se provat janë të pranueshme para Dhomave të Specializuara; se provat do të jenë të disponueshme për tu paraqitur në gjyq kur të vijë koha; se provat do të jenë të mjaftueshme për të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm çdo element të çdo veprë penale për çdo person të akuzuar; se ka gjasa që çështja gjyqësore t'i bëjë ballë një mbrojtjeje vërtet të informuar, inteligjente dhe të fuqishme; dhe se çështja do të përfundojë me dënim që do të jetë i pakundërshtueshëm në apel.

Prokurori i parë i Specializuar

David Shvendiman u emërua Prokuror i Specializuar më 1 shtator 2016 kur TFHS-ja u shndërrua në Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS), pasi kishte qenë Kryeprokuror i TFHS-së nga maji 2015. Mandati i tij si Prokuror i Specializuar përfundoi më 31 mars 2018 kur skadoi emërimi i tij si zyrtar i lartë i Shërbimit të Jashtëm të SHBA-së.

Z. Shvendiman ka qenë prokuror federal i SHBA-së dhe më herët edhe zëvendëskryeprokuror dhe shef i Departamentit Special për Krime Luftë në Bosnjë-Hercegovinë. Para se t'i bashkohej TFHS-së, ai punonte në Kabul, Afganistan, si Ndi-hmësinsektor/Drejtor për Planifikim Paraprak për Kryeinspektorin Special për Rindërtimin e Afganistanit dhe, para kësaj, si atashe i Departamentit të Drejtësisë së SHBA-së në ambasadën amerikane.

Nga viti 2006 deri në vitin 2009, z. Shvendiman shërbeu si prokuror ndërkombëtar në Departamentin Special për Krime Luftë të Zyrës së Prokurorit të Bosnjë-Hercegovinës ku hetoi dhe ndoqi penalisht krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera në Bosnjë-Hercegovinë gjatë luftës së Bosnjës 1992-95. Nga nëntori 2007 dhe deri në fund të vitit 2009, ai ishte zëvendëskryeprokuror dhe shef i Departamentit Special për Krime Luftë.

Z. Shvendiman shërbeu si përfaqësues i Prokurorit të Përgjithshëm të SHBA-së në planifikimin, përgatitjet dhe zbatimin e masave të sigurisë në tri Lojëra Olimpikë – Sidney 2000, Salt Lake City 2002, dhe Athinë 2004. Ai gjithashtu kreu detyra të shumta për Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara në Bahrein, Vietnam, Tajlandë, Bangladesh dhe Afganistan.

Z. Shvendiman e filloi karrierën si prokuror në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm në Utah në vitin 1976. Ai u kthye në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm në Utah në vitin 1984, pasi kishte shërbyer si këshilltar juridik në marinën ushtarake të SHBA-së, ku mori gradën nënkomandant. Ai iu bashkua



David Shvendiman

Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së si ndihmësprokuror në Utah në vitin 1986, ku kreu funksione të ndryshme, ndër të tjera edhe avokat i lartë gjyqësor, ndihmës i parë i Prokurorit të SHBA-së dhe Prokuror i Përkohshëm në Utah, para se të pensionohej nga Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së në vitin 2014.

Z. Shvendiman u diplomua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Utahut (aktualisht Fakulteti Juridik S.J. Quinney) në vitin 1976, ku ka punuar si profesor i jashtëm i së drejtës që nga viti 1994.

ZPS-ja është institucion i pavarur. Pavarësia e këtij institucioni garantohet prej Ligjit që e ka krijuar, si dhe nga amendamenti kushtetues që e mundësoi këtë Ligj. Ligji i Kosovës kushtëzon që ZPS-ja të veprojë e pavarur nga Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe të gjithë prokurorët e tjerë në Kosovë. Ligji i udhëzon Prokurorin e Specializuar dhe personelin e ZPS-së që të mos kërkojnë apo marrin udhëzime nga asnjë qeveri apo burim tjetër.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës caktoi senator Martin për hetimin e pretendimeve të përmendura në kujtimet me titullin *Madame Prosecutor (Zonja Prokurore)* e ish-Kryeprokurores së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ-së), Karla Del Ponte, botuar në prill 2008.

Zonja Del Ponte nuk qe në gjendje që t'i vazhdonte hetimet në TPNJ sepse nuk kishte juridiksion dhe në atë kohë TPNJ-ja kishte miratuar strategjinë përmbyllëse.

Hetimet e zonjës Del Ponte u frymëzuan pjesërisht nga raportet e Majkëll Montgomerit (Michael Montgomery), gazetar nga SHBA-ja i cili zbuloi prova të krimeve mizore të kryera pas përfundimit të fushatës ajrore të NATO-s të vitit 1999. Z. Montgomeri përgatiti një memorandum ku parashtrroi me hollësi konstatimet e veta dhe të cilin ia dha Misionit Administrativ të Përkohshëm Kombeve të Bashkuara, autoriteti administrativ i asaj kohe.

Vendimet për ndjekje penale

Në bazë të rregullës 86 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave shpallur nga Dhomat e Specializuara në korrik 2017, para dorëzimit të aktakuzës, Prokurori i Specializuar duhet të bindet se "ekziston dyshim i bazuar mirë se një i dyshuar ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

Krahas kësaj si dhe duke u nisur nga praktikat profesionale më të mira, David Shvendiman hartoi udhëzime të mëtejshme për prokurorët e ZPS-së në të cilat përcaktoi se ai do të ngrinte akuza vetëm me përmbushjen e këtyre pesë kushteve:

- se provat në mbështetje të aktakuzës janë të pranueshme para Dhomave të Specializuara;
- se provat do të jenë të disponueshme për tu paraqitur në gjyq kur të vijë koha;
- se provat do të jenë të mjaftueshme për të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm çdo element të çdo veprë penale për çdo person të akuzuar;
- se ka gjasa që çështja gjyqësore t'i bëjë ballë një mbrojtjeje vërtet të informuar, inteligjente, dhe të fuqishme; dhe
- se çështja do të përfundojë me dënim që do të jetë i pakundërshtueshëm në apel.



David Shvendiman

Pas publikimit të Raportit Marti, BE-ja formoi Task Forcën Hetimore Speciale (TFHS) për hetimin e pretendimeve në të. TFHS-ja e kishte bazën në Bruksel dhe fillimisht u kryesua nga ish-ambasadori i SHBA-së për çështje të krimeve të luftës, Klinton Uilliamson (Clint Williamson). Z. Shvendiman zëvendësoi ambasadorin Uilliamson si Kryeprokuror i TFHS-së në maj 2015.

Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015, përcaktoi mënyrat dhe mjetet për vazhdimin e hetimeve dhe procedimin penal të çfarëdo akuze të dalë prej këtyre hetimeve. Ky legjislacion mundëson zhvendosjen e procedurave gjyqësore jashtë Kosovës dhe punësimin e personelit ndërkombëtar.

Madame Prosecutor

Në kujtimet e saj, *Madame Prosecutor* (Zonja Prokurore), që fillimisht u botuan në Italisht me titullin *La caccia: lo e i criminali di guerra* (Gjuetia: Unë dhe kriminelët e luftës) në prill 2008, Karla Del Ponte, ish-Kryeprokurore e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), ia kushtoi kapitullin 11 hetimeve të saj në lidhje me Kosovën. Në këtë kapitull, zonja Del Ponte shkruan për pretendime të rënda, duke përfshirë dhe ato në lidhje me heqjen e organeve, që ajo beson se duhet të hetohen.

Hetimet e zonjës Del Ponte u frymëzuan pjesërisht nga raportet e Majkëll Montgomerit (Michael Montgomery), gazetar nga SHBA-ja i cili zbuloi prova të krimeve mizore të kryera pas përfundimit të fushatës ajrore të NATO-s të vitit 1999. Z. Montgomeri përgatiti një memorandum ku parashtrroi me hollësi konstatimet e veta dhe të cilin ia dha UNMIK-ut. Gjithashtu, z. Montgomeri e shoqëroi zonjën Del Ponte gjatë vizitës së vendeve të krimeve të pretenduara në Shqipëri në vitin 2004.

Pas botimit të librit të zonjës Del Ponte, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës caktoi sena-

torin zviceran, Dik Marti, për hetimin e këtyre pretendimeve. Rezultatet e hetimeve të senator Martit u bënë publike në Raportin e janarit 2011 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, *Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë*, që tani njihet si "Raporti Marti".



Madame Prosecutor, kujtimet e Karla Del Pontes

Memorandumi i Montgomerit

Majkëll Montgomeri, gazetar nga SHBA i cili nga 1988 deri më 1995 ishte korrespondent në Ballkan për *The Daily Telegraph*, u kthye në Kosovë në korrik 1999 pas fushatës ajrore të NATO-s dhe tërheqjes së forcave jugosllave. Ai shkoi atje që të hetonte dhe bashkërealizonte një dokumentar për radio me titull *Masakra e Qyshkut*, i cili dokumentonte vrasjen e fshatarëve shqiptarë nga forcat serbe.

Gjatë hetimeve të tij, z. Montgomeri nxori në shesh pretendimet për krime mizore të cilat ai i përfshiu në një memorandum që ia dha UNMIK-ut i cili ishte autoriteti administrativ në atë kohë. Në vitin 2004, z. Montgomeri shoqëroi një ekip të he-

tuesve nga UNMIK-u dhe TPNJ-ja të cilët hetuan këto pretendime.



Majkëll Montgomeri duke punuar në Kosovë
(© Stephen Smith)

Në janar 2016, Holanda dhe Kosova nënshkruan marrëveshjen e përkohshme për shtetin pritës, sipas të cilës Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja do të vendoseshin në Hagë.

ZPS-ja synon të arrijë rezultate legjitime dhe që konsiderohen legjitime nga ata që do ndikohen nga këto rezultate në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Vetëm në këtë mënyrë mund të hiqet njolla e ngjarjeve trajtuar në Raportin Marti, që është pengesë për integrimin e plotë të Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare.

Më 31 mars 2018, me përfundimin e emërimit të tij si zyrtar i lartë i Shërbimit të Jashtëm, z. Shvendiman e përfundoi mandatin si Prokuror i Specializuar. Atë e ka zëvendësuar përkohësisht zëvendësprokurori i specializuar Kwai Hong Ip.

Përveç postit të zëvendësprokurorit të specializuar, z. Ip ka qenë dhe zëvendëskryeprokuror i TFHS-së dhe ushtrues i detyrës së Kryeprokurorit të TFHS-së nga ikja e ambasadorit Uilliamson në gusht 2014 deri në ardhjen e z. Shvendiman në maj 2015.

Task Forca Hetimore Speciale

Nga shtatori 2011, kur filloi punën, e deri kur u shndërrua në Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në shtator 2016, Task Forca Hetimore Speciale (TFHS) administroi hetimet penale të veprave të raportuara në raportin e janarit 2011 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, *Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë*.

TFHS-ja e kishte selinë në Bruksel, financohej nga BE-ja dhe nga shtatori 2011 e deri në maj 2015, u udhëhoq nga ambasadori i atëhershëm i SHBA-së për çështje të krimeve të luftës, Klint Uilliamson. Kwai Hong Ip ishte ushtrues i detyrës së Kryeprokurorit të TFHS-së nga gushti 2014 deri në prill 2015. David Shvendiman u emërua Kryeprokuror

në maj 2015 dhe vijoi të ishte në krye të TFHS-së deri në shndërrimin e saj në ZPS.



Ambasadori Klint Uilliamson

Në fjalën e vet lamtumirëse si Prokuror i Specializuar në Qendrën Grotius të Universitetit të Leidens në Hagë, z. Shvendiman foli për zanafillën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, për sfidat me të cilat ishte përballur si Prokuror i Specializuar si dhe për sfidat me të cilat do të përballlet organizata në vitet e ardhshme.

Bashkimi Evropian ka filluar procesin e emërimit të pasardhësit të z. Shvendiman i cili mund të jetë nga cilido shtet anëtar i BE-së, apo nga një prej shteteve kontribuuese: Kanadaja, Norvegjia, Zvicra, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Fjala lamtumirëse e Shvendimanit

Në fjalën e vet lamtumirëse si Prokuror i Specializuar në Qendrën Grotius të Universitetit të Leidenit në Hagë David Shvendiman foli për zanafillën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, (ZPS), sfidat me të cilat ishte përballur si Prokuror i Specializuar dhe sfidat me të cilat do të përballlet institucioni në vitet e ardhshme.

Fjala e z. Shvendiman me titullin “Reflektime nga përvoja ime si Prokurori i Specializuar dhe sfidat e ardhshme”, u mbajt në një sallë të mbushur plot të Universitetit të Leidenit ku ndër pjesëmarrësit kishte juristë, gazetarë, diplomatë dhe studentë.

Z. Shvendiman foli për vështirësitë e procesit të mbledhjes së dokumentacionit dhe gjetjes së dëshmitarëve dhe materialeve të tjera që mund të kenë vlerë provuese, duke argumentuar se për këtë duhet durim, këmbëngulje si edhe diplomaci.

Prokurori i Specializuar foli edhe për nxjerrjen para përgjegjësisë dhe theksoi: “Detyra kryesore e prokurorit është përcaktimi i përgjegjësisë; përgjegjësi individuale për krime të vërtetuara jashtë dyshimit të arsyeshëm në bazë të provave të mbledhura me mjete dhe mënyra të pranuar si të ndershme dhe të besueshme jo vetëm në bazë të

standardeve ndërkombëtare, por edhe në sistemin vendor përkatës”.

Ai theksoi se: “Përgjegjësia duhet të jetë për veprime individuale dhe jo përgjegjësi e një grupi për veprime që mbulon Ligji special.”

Teksti i plotë i fjalës lamtumirëse të z. Shvendiman gjendet [në faqen e ZPS-së në Internet.](#)



David Shvendiman në Qendrën Grotius

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës – Raporti i parë, 2016-2018

Botimi dhe shpërndarja nga: Dhomat e Specializuara të Kosovës

Botuar në tri gjuhë: shqip, anglisht, serbisht

Më shumë informacion mund të gjeni në faqen e DHSK-së në Internet: www.scp-ks.org

Adresa elektronike për pyetjet nga mediat lidhur me Dhomat e Specializuara është: mediaKSC@scp-ks.org

Adresa elektronike për pyetjet nga mediat lidhur me Zyrën e Prokurorit të Specializuar është:

spokespersonSPO@scp-ks.org

Paraqitja grafike: [M-space grafisch ontwerpers](http://M-space.grafisch.ontwerpers.nl), The Hague



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS